

# Oral History Kosovo

---

## INTERVISTË ME MIHANE SALIHU-BALËN

Prishtinë | Data: 9 mars, 2018

Kohëzgjatja: 130 minuta

Të pranishëm:

1. Mihane Salihu- Bala (E intervistuar)
2. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
3. Donjetë Berisha (Kamerë)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Aurela Kadriu:** Të lutem prezentoje vetën, emrin, mbiemrin edhe nëse mundesh me na tregu diçka për kujtimet e hershme t’fëminisë. Domethonë familjën tonde, prapavinë e familjës, ambientin ku jeni rritë, vendin ku jeni rritë?

**Mihane Salihu-Bala:** Unë jom Mihane Nartilë Salihu Bala. Jam e lindur në Prishtinë. Jam rritë, shkolluar në lagjën e Kodrës të Trimave, ish Vranjevci. Vij nga një familje e rëndomët, kushtimisht. Jam fëmiju më i madh i familjes. Jemi gjashtë fëmijë nga nëna. E veçanta ime është që unë jam rritë n’shtëpinë e nënës, edhe kjo mënyrë e t’menduarit që ka qenë tek vitet ‘70-ta, ‘80-ta ka bartë njifarë mënyre formësimin tim. Sepse në mënyrën e të menduarit t’kohës e të rritunit në shtëpinë e nënës ishte më ndryshe, jo si të gjithë të tjerët. Edhe kjo më tepër e karakterizon fëmijërinë time. Përndryshe një fëmije çapkën, i gjallë, rebel, kurreshtar. Por për shkak t’rrethanave në të cilat jom rritë unë nuk kemi pasë shumë t’afërt, familjarë t’afërm që kanë qenë shumë afër nesh.

Edhe në mungesë të tezeve, dajave kemi gjetë një zëvendësim tjetër tek kushërinjët më të largët t’familjës nga nëna... Edhe përgjithësisht kështu jom rritë. Do të thotë si fëmiju i parë i familjës, me mundësinë e të menduarit që duhet t’bahesh e mirë, e guximshme, krejt. Se varësisht nga sjelljet e tua tjerët do të vijnë mbas teje. Është ajo moto që m’ka përcjellë ma shumë, “Ka t’shkon rrota e parë, shkojnë tjerat”. Është ndoshta jo e kandshme t’thuhet bash ky perceptimi po n’përgjithësi këto kanë qenë mënyrat e të menduarit në vitet e ‘70-ta kur une jam lindë edhe jam rritë. Në vitin shkollor ‘79, ‘80 kam hi klasa e parë, në shkollën “Zenel Hajdini”...

**Aurela Kadriu:** A po ndaloni veç edhe pak... m’fal, kush tjetër ka qenë pjesë e familjës tuj?

**Mihane Salihu-Bala:** Në familjën time kanë qenë të dy prindërit, edhe kemi pa... Unë edhe tre motra edhe dy vëllezër tjerë. Do te thotë jemi gjashtë fëmijë. Kemi jetuar në shtëpinë e nënës. Nëna ima ka mbetë shumë herët pa prindër. Ka qenë fëmijë i vetëm. E trashëgimia e saj ka qenë, është shumë interesante... Baba i saj ka qenë, gjyshi im ka qenë i mbijetuar, rob luftime nga Gjermania, me një përzirje të ndryshme etike nga të tjerët. Edhe pasi që është kthyer, pas Luftës së Dytë Botërore kur është kthyer nga kampet e përqendrimit që kanë qenë në Gjermani është takuar, është martuar me gjyshën time. Edhe ajo ka pasë një përvojë interesante në jetë, edhe ajo ka qenë e mbijetuar e Luftës së Dytë Botërore. Edhe ka nënën time fëmijën e vetëm.

Nëna ime është rritur në, në fshatin Prapashticë, malësia e Golloakut atje. Edhe pse me origjinë nuk janë, ata kane bërë lëvizje të ndryshme. Edhe në moshën 16 vjeçe janë shpërngulë në Prishtinë. Nana

ime në moshën 18 vjeçe është martuar edhe pas katër-pesë viteve, jam une fëmiju i parë. Mirëpo ajo çka është momenti interesant është që në ditën që unë jam e lindur, nëna ime s'bashku me babin tim, në fakt ma shumë vendim i babës tim se sa i nënës time, janë kthyer t'kujdesen për prindërit e nënës time. Sepse kanë qenë të sëmurë, kanë qenë të vetëm edhe s'kanë pasë... Kështu që ajo është që unë jam rritë në shtëpinë e nënës. Në fakt, dita që unë kam lindur, edhe pse prindërit e mi m'kanë pritë ndoshta me shumë dëshirë e... është gjithashtu dita që bëhet edhe një lindje, por edhe, edhe jo shumë, shumë gëzim i madh për shkak se babai im i len prindërit e tij të vij e të jeton, të kujdeset për prindërit e gruas.

Edhe po flasim për vitet e '70-ta kur kjo mënyrë e të menduarit ishte një stigmatizëm shoqërorë sepse megjithatë duhet të kujdesen djemët për prindërit, në atë kohë. Mirë po për shkak të rrethanave që nëna ime nuk kishte as vlla, as motër... Kështu unë mbaj n'mend gjyshën e gjyshin shumë pak, se ata pas një kohe kanë vdekur. Domethanë kam qenë shumë e vogël, dy vjeçe gjysmë, ndoshta tre. Edhe kjo është, sa i përket fëmijërisë.

Kujtimet që mbaj n'mend unë nga fëmijëria janë ajo liria absolute me lujtë n'oborr. E kemi pasë një shtëpi të vogël me një oborr. Ajo bota jonë brenda atij të rrethuar, se ishte, nuk ishin me mure te lartë po ishin me ca, neve i quanim teneqe. Ashtu kanë qenë ato rrethojat me fleta metalike nga ato boret e prera t'kohës. Po jo veç shtëpia ime, jo veç shtëpia ku unë jetoja, po ishte pothuajse tërë lagjja, tërë rruga ishte... ose kishte ca mure të vjetra të ndara, ose me këto rrethojat prej teneqeve. Po çka mu m'kujtohet më shumë janë ato deriçkat, dyert jo nga rruga, po dyert nëpër mure që lidhnin fqinjët me njëri-tjetrin dhe njëfarë mënyre kaloje nga një shtëpi tek e dyta, e treta e katërta, e pesta nëpër oborret e njerëzve, nëpër oborre t'shtëpive të tjerëve.

Ndoshta si fëmijë ka qenë shumë interesante sepse bënim sherre dhe iknim nga ato dyert. Jo për të dalë në rrugë, edhe pse rruga ka qenë një rrugë e ngushtë mesatare e Prishtinës me baltë, jo e asfaltuar. As kanalizim s'kemi pasë, do të thotë po flasim për atë kohë... Edhe asnjherë s'kam mendu si fëmijë pse këto deriçka, mirëpo e dija që gratë e shtëpive të ndryshme shkonin nga njëra shtëpi në tjetrën. Ose për të pirë çaj, ose për t'nejtë te njena-tjetra, ose... njëfarë lloj socializimi.

Ajo është, nga fëmijëria ime është deriçka është njëfarë lloj simboli i fëmijërisë. Ishte një portë tjetër fare e komunikimit, e lëvizjes... Sepse kur shkoje dikund, hyje nga dera nga dera kryesore dhe ishin, ishin dyer... varësisht ku shkoje, ishin dyer të mëdha, të mbyllura që e kishin njëfarë shuli mbrapa që duhet të trokitshe, duhej dikush ta hapte derën. Pra ato familje që kanë mbajtur kafshë shtëpiake, qej, ka qenë shumë problem të trokitshe te dera kryesore se njëherë duhej të shihje se a është qeni i lidhur a jo. E kjo është ajo që unë mbaj n'mend ma shumë prej fëmijërisë, ato deriçka që t'çonin nga një shtëpi në tjetrën.

Në fakt pse përmenda deriçkat kështu kto dy deriçkat e vogla të gardheve, të mureve është se shumë më vonë, tek vitet e '85, '86, '87... Çdo herë kur ka pasë protesta kur unë kam qenë pjesëmarrje me... aktive, me dëshirë, a pa dëshirë se m'ka nxanë rruga ose kam ardhë prej shkollës m'ka nxanë protesta... ato deriçkat kanë qenë shpëtim i t'gjithë neve që s'kemi pasë naj forcë fizike ashtu t'ballafaqohemi kushtimisht me dajakun e policisë. Sepse njerëzit i kanë përdorë ato deriçka për t'i shpëtuar njerëzit, për të dalë...

Edhe mbaj n'mend kur, në vitet '80-ta, kur në lagjën tonë, në rrugën tonë ku kom jetu unë, ka pasë shpesh herë problem që policia kanë ardhë, kanë bastisë shtëpitë e ndryshme. Qoftë për aktivizëm t'njerëzve që kanë qenë, qoftë për gjëra të ndryshme. Dhe mjaftonte një e fishkëlluar dhe të gjitha deriçkat hapeshin. Dhe deri sa kontrollonte policia nga dera kryesore, të rinjtë, në shumicën e madhe të rinjtë, djemtë iknin nga ato deriçkat.

Ky është një kujtim interesant që mua nuk më ka rastisë ta diskutoj më herët, ta prezentoj, ose ta përmend. Edhe efekti pozitiv, edhe pse ndoshta, ndoshta kjo ka t'bëjë me perceptimin... vitet '91, '92, '93 kur presioni policor ka qenë ma i madh për të mbledhë t'rinjtë për shërbimin ushtarak. Edhe mu këto deriçka kanë qenë shpëtimi i shumë njerëzve sepse nëse në një rrugë tjetër ka fillu aksioni policor për t'i mbledhë është lajmëru rruga tjetër, mu përmes këtyre deriçkave. Dhe kështu që të rinjtë kanë lëvizë nga njena pjesë e rrugës, në pjesën tjetër.

Në rrugën ku unë jom rritë, në lagjën ku unë jom rritë, sot nuk është, nuk ekziston mo institucioni kushtimisht i deriçkave. Nuk ka, kanë fillu ndërtimet e reja, ka një situatë tjetër. Edhe për fat të keq nuk është rujtë asnjë nga to. Në të parë duket, tani duket që ishte funksionale edhe pse atëhere ka pasë një kuptim krejt tjetër fare. Do të thotë ka qenë ekskluzivisht për ato raportet me të afërta midis fqinjëve që i kanë përdorë veç gratë ndoshta më tepër sepse ka qenë në shëpi. Edhe rruga ka qenë njëfarë lloj hapësire e ndaluar për gratë. Sepse të dilni dy gra të bisedonin tek dera kryesore në rrugë nuk është pritë mirë sigurisht edhe menjëhere është emërtuar me një emër tjetër. Edhe në aspektin shoqëror kanë mbijetuar përmes atina shoqërimit të deriçkave do e quaj prapë, atyre laurave ndosha më tepër po që nuk e ka pasë kuptimin e tillë atëherë.

Çka mbajë n'mend tjetër unë nga fëmijëria ime është që jemi knaqë me pak gjëra. Jemi knaqë me ato kukullat që i kemi maru vetë me lecka. Mbaj n'mend lojën "Partizanët edhe gjermanët" që ka qenë, atëhere ka qenë një lloj hiti, që më vonë e kam kuptuar që ka qenë një dogmë, që ka qenë një frustrim që është bërë tek fëmijët. Mirëpo kanë qenë gjëra që t'gjithë i kanë bërë ashtu.

Më kujtohet loja, luanim "tezesh". Njëfarë mënyre mësoheshim përmes lojës, në mënyrë të pavetëdijshme se si duhesh t'jesh grua. Duhet t'jesh e dëgjueshme, duhet t'jesh e kujdeshme, duhet t'kujdesesh për t'gatuat, për t'pritë, për t'larë, për t'fshirë. Këto janë gjëra që m'kujtohen edhe puna e dorës. Ato gra që uleshin t'punonin me qerqefët, me atë gjilpërën. Edhe pse këtu në Prishtinë i thoni kasnak asaj të rumbullaktës. Edhe m'kujtohet gjyshja ime nga baba që vinte, që punonte me shtiza, me krrabëza. Ato qorapat e leshta, ose ato jelekët, ato bluzat, jo nuk iu thonin bluza, u thonin xhemper n'atë kohë. Edhe ata pantollonat me krahsa, ato kanë qenë shumë interesant si punoheshin, si punë dore.

Pse them m'kujtohet ajo sepse tërë ditën bënim punë t'shtëpisë, merreshin me fëmijët, me t'gatuatit, më t'fshirët. Edhe në momentin që uleshin për të pirë noj çaj ose për të, kur ikin fëmijët për t'bërë gjumin e ditës detyrimisht ose të mbrëmjes, ato i merrnin ato kërrabzat e thurrnin. Bënim punë shumë interesante, punë dore që sot i ka humbur vlera. Mu m'kujtohen ato mbulesat e tavolinës, ose gjëra të ndryshme që bëheshin me aq pasion, me gjithë ato ngjyra që bëheshin. Edhe si bëhej ajo gjilpëra tik tik tik {onomatope} ashtu punohej. Këtë mbaj n'mend më tepër sepse nuk kishte ndonjë argëtim ndoshta tjetër.

Edhe, po, zëri i radios. Zëri i radios ka qenë çdo herë prezent i fëmijërisë time. Sepse televizori ishte, po nuk ishte çdo herë ose s'kishte programe të mira për fëmijë, ose kishte programe që lajme që... Edhe nëna na lëshonte radion, Radio Kukësin e mbaj n'mend si fëmijë. E tani kur jam rritë ndoshta klasa e dytë, tretë, Radio Prishtinën. Kjo është ajo fëmijëria ime edhe mbaj n'mend që n'shkollë kemi qenë shumë nxënës, te klasa e parë kemi qenë 45, 46 nxënës në klasën e parë. Edhe kemi qenë të gjithë ashtu të veshur thjeshtë, të ndrojtur nga klasa në klasën e parë. Të ndrojtur edhe nga mësuesja edhe të gjithë. Sepse na thonin, "Në shkollë nuk mund të bëshë zhurmë, në shtëpi mund të bëshë pak, po në shkollë jo".

Kjo është çka mbaj n'mend, ndoshta një momentin tjetër janë, tash ishte koha e... që ishin ca ditë të ftofta, që u bë pak akull, mbaj n'mend dimra të gjatë në Prishtinë. Edhe kur krejt lagjja, krejt fëmijët e lagjës organizoheshin nga trafoja deri te hekurudha te Hani i Dilit, lëshonin ujë natën edhe ngrihej bëhej akull. Edhe ishte maratona e sajave. Edhe neve ju thonim sliquka, janë si lloj patina të vogla rrëshqitëse, saja të vogla, skija të vogla për këmbë që bëheshin nga gajbet e plastikës mundësisht të Koka-kollës kanë qenë, ose të Pepsit, ose të Jupit ose s'po di çfare kanë qenë. Edhe ishte, krejt halli ishte për t'i bërë të mira, me gjetë qatë gajben dikund, se nuk kishte bash gjithkund atëhere. Për t'a prerë drejtë, për t'a kthyer me ujë të nxehtë për t'i bërë ato që të rrëshqitëshin edhe për t'i lidhë ato edhe sajat. Kështu që bëhej vargu i fëmijëve, nuk e di, ndoshta nja 150-200.

Shfrytëzoni një hapësirë që sot kur ecë me këmbë bon dikun dy minuta por neve na u doke gjatë, se ishte dikund nja 200 metra teposhtë. Këta unë e mbaj n'mend, pritnim në rend për t'u lëshuar teposhtë akullit. Edhe ishte ajo turma, e të piskiturat... ose mbaj n'mend se nuk ka pasë shumë vetura, edhe kur kalonte treni... Eh në kohën kur kalonte treni ishte, ishte ajo heshtja 5 minutshe ashtu, askush s'lëvizte, se mos nuk arrinin t'a ndalonim te hekurudha po shkonim edhe më poshtë e ishte ajo... se tash ka kalu treni, a din, t'shkelë treni.

Ishin interesant ato momentet. Edhe ajo çfarë m'kujtohet është që sa zhurma bëhej për të hyrë brenda. Njihere në mëngjes për me dalë jashtë, tani për t'hy brenda, se nuk donim të ktheheshim brenda. Edhe ato, tani m'kujtohen ato gratë e rrugës time sa herë na lëshonin ndonjë fjalë ashtu, "E të bëftë, e të ngrëntë..." E të gjitha ato, por jo në kuptimin negativ, ishte shprehje mllëfi. Se ato të ngratat tërë ditën punonin edhe në mbrëmje duheshin t'i mbledhin fëmijët. Po për t'u kthy në shtëpi në mbrëmje ishte telashe se kishim dëshirë t'rrinin jashtë. Por nuk ka pasë ndriqim rruga kështu që me perëndimin e diellit iknin në shtëpi të gjithë. Këto mbaj n'mend nga fëmijëria e hershme, po flas deri i kam bërë dhjetë vjet ndoshta. Pastaj ka ndryshuar situata.

**Aurela Kadriu:** E përmendët që gjyshi edhe gjyshja kanë qenë të mbijetum të Luftës së Dytë Botërore, a na tregoni pak për këtë pjesë? Ndoshta qoftë kujtimet që i keni dëgju prej nanës t'juj, meqenëse thatë që s'keni jetu shumë me gjyshin edhe gjyshën?

**Mihane Salihu-Bala:** Zër rob lufte në, në Luftën e Dytë Botërore i bie. Ka qenë shumë i ri në moshë, dikun 15, 16 vjeçar. Edhe ka shpëtuar falë gjatësisë që e ka pasë, pamjës. Edhe dikush që kur e kanë pytë se çfarë je, një shqiptar që ishte me të thotë, "Është Muhamedan". Përndryshe ai e ka pasë emrin Adam edhe nga atëhere e ka bërë Adem. Kështu që ka mbijetuar falë dikujt që ka thanë se është muhamedan. Se ka qenë më i bardhë, më ndryshe.

Ajo çfarë unë mbaj n'mend nga rrëfimi që më është bërë për mbijetesën e gjyshit është që kur kanë mbërri, kur kanë kaluar Slloveninë do të thotë, sepse janë nxënë diku në Bosne, në këmbë i kanë përcjellë. Kur kanë kalur Slloveninë do të thotë, se gjyshi ka njohur gjuhët sllave, po jo gjuhët gjermane. Ata kanë hangër patate të pa ziera edhe kanë mbijetuar në mënyra të ndryshme. Gjyshi për herë të fundit do të thotë nga kalimi prej Sllovenisë, prej tokave të Sllovenisë në drejtim, sigurisht të Austrisë në atë kohë. Tani është konsideruar si i humbur, familja e kanë vajtuar, e kanë ditur që është i vdekur sepse për pesë vjet nuk ka pasë ndonjë komunikim që dihet që është i gjallë. E peripetitë e gjyshit është që ai përfundon në pjesën që më vonë njihej si Republika e Gjermanisë Lindore, federalja.

Edhe përjetimin që unë mbaj në mend nga rrëfimi është që në momentin e fundit një, një ushtarak i lartë gjerman e lutë që ai t'ia kapërcen vajzën e tij në pjesën federale, që ishin në fakt nën kontrollin amerikan. Edhe ai tregimi që ajo karroca me kuaj ka kalur nëpër butan t'nxehet, zift. Do të thotë që është nda njëfarë rruge ashtu që mos t'kalon, ai e ka kaluar. Edhe është kthyer në Kosovë. Ka gjetë familjen, do të thotë ka gjetë motrat e tij fillimisht. Është kthyer për t'jetuar në vendin ku është rritë si i ri.

Mirëpo ajo çfarë është shumë interesante është sepse ai asnjherë nuk është kompenzuar për statusin që e ka pasë si rob lufte në Gjermani. Do të thotë ka vdekë në, tash në '76, '76 do të thotë edhe nuk ka marrë asnjë kompenzim material për kohën që ka qenë rob lufte në Gjermani. Pse ka ndodhë kjo, nuk e di. Nuk është që s'ka pasë ndonjë shënim apo... mirëpo, eh fate jetësh. Politika ndoshta, ndoshta naj situatë tjetër që nuk e dijmë ne, është që ai nuk ka pasë ndonjë pension dhe kompensim material. Edhe pse në ish-Jogusllavi iu është dhënë kompenzim njerëzve që kanë qenë rob lufte në atë kohë.

Nuk mbaj n'mend shumë nga rrëfimet e tij, madje as nëna ime nuk flet për to. Ndoshta ka pasë një arsye, thjeshtë për t'na kursyer neve prej dhimbjes, prej emocionit, prej stresit, prej frikës. Mirëpo, tregimet kanë qenë kryesisht këto të dhimbshmet se si ka mbijetu ai ditët kështu. Si është gjind, sepse e ka mësu gjermanishtën shpejtë.

Ndërsa gjyshja, nga gjyshja, nana e nënës time, kujtimet që më janë përcjellë mu janë se si ajo ka mbijetu luftën, si ka qenë e mbijetuar e luftës, e dhunës që është bërë. E dhunës tek familja e cila ka qenë në atë kohë, se si ushtarët e formacioneve të ndryshme i kanë malltretu gratë, burrat, iu kanë djegë shtëpitë, iu kanë marrë rrobat. I kanë plaqkitë si thuhet, si i kanë torturuar në mënyra të ndryshme po... Nuk është e shkruar edhe ajo që është me e keqja është që tregimet që bahen janë për njerëz që kanë vdekë, edhe të vdekurit kanë pasë një status s'flet askush as mirë as keq për ta. Mbahet si kujtim edhe shtoja atë që nëna ime s'ka pasë as vlla as motër, është diçka që nuk ka dashtë ta ngarkoj as vetën as fëmijtë e saj me tregime të dhimbshme. Është munduar t'mbijetoj, thejshhtë është munduar të mbijetoj në rrethanat që i ka pasur. Edhe kjo është tregimi që, që vije nga e kaluara.

Ndërsa nga ana e babait, gjyshi im ka qenë luftëtar i kohës edhe ai e ka mbijetu Tivarin edhe ka mbijetu Frontin e Sremit. Mirëpo as ai nuk është kompenzuar asnjherë për atë, se në dosjet që është bërë thotë që kemi qenë edhe ushtar i mbretit Zog. Tash kjo është ajo kontradita që përcjellë, e përcjellë, përcjellë njerëzit, individët. Të jesh i mbijetuar i Tivarit, të mbërrish deri në Istri, pastaj të jesh edhe i mbijetuar i Frontit të Sremit, që ishte një luftë shumë e madhe... Dhe në fund të mbetësh pa asgjë është, kjo ëshë, unë do të thoja ishte ky kryqi kalvar i njerëzve që e kanë bartë.

E pastaj, mu për shkak të asaj se thuhet se ka qenë ushtar i mbretit Zog, nuk ka ndonji privilegj, nuk ka një vend pune, nuk është i pranuar për sistemin. E pasojat e saj i vuajnë edhe fëmijët e tij. Do të thotë një vrafni e madhe e kohës, jo veç për të po për të gjithë. Edhe pamundësia për t'i shkolluar fëmijët sepse ata që nuk ishin të vijës partiake nuk mund të i shkollonin fëmijët. Do të thotë me pak fjalë, kjo është.

Pastaj babai im është fëmiu i katërt, i dytë në familje nga pesë vllazër edhe tre motra, nga tetë fëmijët e gjyshit edhe gjyshës nga ana e babit. Po për shkak të mundësive materiale ai nuk ka qenë në shkollë, ai ka qenë rroktar në një familje në Kosovë. Edhe në moshën 16 vjeçe kur ma nuk ka qenë rroktar tek zotëria, ka filluar të punoj njëherë në ndërtimtari pastaj ka kaluar të punoj në hekurudhë. Atëherë është nënshtruar arsimimit gjatë punës. Kanë qenë ato shkollat e veçanta për punëtor.

Babai im ka qenë njohës i... njohës, tash nuk ka ndoshta një ekuivalent, po ka qenë profesionist në, i transportit hekurudhor. Do të thotë ka kryer shkolla, ka kryer... në atë kohë për çdo vit kanë pasë shkollim të detyrueshëm edhe provimet e detyrueshme. Sot do të njëhej njëfarë inxhinier i transportit hekurudhor. Mirëpo atëherë nuk e kanë pasë këtë, këtë titull. Edhe ajo që i vinte interesant, është që babain tim e kanë larguar nga pozita e udhëheqëse për shkak të religjionit. Ai ka dashtë t'a mbajë religjionin e tij edhe është deklaruar që nuk heqë dorë nga religjioni për partinë. Edhe nuk e kanë avancuar, në fakt ata e kanë heqë nga pozita dhe... nga pozita e udhëhe... e drejtuesit të lokomotivave e kanë qitë në punëtor të thjeshtë të mirëmbajtjes.

Edhe pastaj kështu shkon edhe kohë pas kohe.... Pas një kohe të gjatë ai prapë kthehet për të punuar, por jo në profesionin e vet, jo si drejtues i lokomotivave. Ka punuar për një kohë të gjatë me hekurudhë edhe në fund, do të thotë pas vitit '99 mbetet i pa punë si shumica e, shumica e njerëzve. Pas luftës nuk ka gëzuar asnjë pension, asgjë. Edhe ka vdekur me telashet e jetës. Pa pension do të thotë, pa një, pa pasë mundësi ta mbajë vetën nga puna e tij, edhe pse ka punuar 45 vjet. Kjo është.

Ndërsa nëna, nëna ka të kryer një shkollë fillore të kohës. Do të thotë pas viteve, ajo është e lindur në të '50-ën... të kohës. Edhe është marrë më rritjen tonë që nga dita e parë. Në fakt ka qenë shtytësi më i madh që ne të rritemi, të na edukon, që të shkollohemi. Ndoshta knaqësia e saj e vetme që mund të matet me diçka është që të gjashtë fëmijët e saj kanë kryer një shkollë të mesme, kanë kryer një fakultet. Dhe tre nga ta janë me një master, tre të tjerët janë me një fakultet. Kështu që... mirëpo si të gjitha nënat nuk është e kënaqur, çdo herë me të arriturat... dhe ka pritshmëri që fëmijët e saj meritojnë më të mirën duhet t'a kenë.

E zhgënjimi i saj tani është që shumica jemi të papunë (qeshë) edhe është ajo rëndesa për nënën, është rëndesa që nuk ka pasë mundësi për të bërë diçka më shumë ndoshta. Edhe pse nuk është faji i saj, po si çdo nënë e ndien atë rëndesën e kohës. Ka dëshirë që fëmijët të jenë më të mirë, t'kenë më shumë. E unë bëj shpesh shaka me të, prej kur ka nipa dhe mbesa ajo është gjithë zemër për nipa, për mbesa. Ata janë më të mirët për të, nuk iu bërtet, nuk iu thotë, "Jo". Nuk iu thotë, "Mos". Që për neve ka qenë krejt e kundërta, po.

Shpesh thotë që nuk e kuptojmë, kur të vijmë ne në pozitën e saj do i kuptojmë gjërat më ndryshe. Po parë nga perspektiva ku jam tani, është e çuditëshme si një njeri që ka qenë shumë më e rreptë, shumë ma strikte, me nipa e me mbesa bëhet e butë ashtu. I len t'bëjnë çfarë të dojnë, kjo është ajo që ndoshta më vonë, ky është ndryshimi që mund t'a vrejë tani për kohën.

**Aurela Kadriu:** Çfarë përketesie religjioze ka pasë babi meqenëse është përjashtu për shkak t'saj?

**Mihane Salihu-Bala:** Familja ime vjen nga familje e përzirer. Babi im ka vdekë si musliman. Edhe për shkak të ramazanit e kanë largu nga partia. Ndërsa nëna është shqiptaro-hebreje. Ne në familje jemi rritë me të gjitha religjionet tradicionale. Ne fëmijët shumica jemi të pagëzuar. Kështu që jemi një përzierje do të thoja interesante e kulturave të ndryshme. Sepse në fund të fundit religjioni është diçka që është veç për vete jo edhe për të tjerët. Mirëpo tu e pasë parasyshtë që jemi rritë në një ambient zyrtarisht tjetër, edhe jo zyrtarisht tjetër, atëherë mundësia për të zgjedhë diçka ka qenë më e madhe, po ka qenë edhe më e vështirë. Edhe pse të rritesh në një ambient ku kusherinjtë e tu janë të një përkatësie tjetër fetare, dhe ti ke mundësi të bësh një zgjedhje tjetër është... nuk ka qenë mirë e pranuar atë kohë.

Mirëpo tash në fund të fundit gjithë flasin një gjuhë edhe ndryshimet kanë ardhë më të mëdha dhe pranueshmëria është më e ndryshme. Edhe pse dallimet janë shumë të mëdha tani për tani. Sepse një kohë kemi hangër të gjithë bukë në një familje, kishte festa të ndryshme, bëheshim bashkë. Nuk ishte me randësi shumë çfarë ishte, po bëheshim bashkë. Tash është një lloj protokoli tjetër fare, mirëpo ende mirë jemi (qeshë) ende mirë.

**Aurela Kadriu:** A na tregon qysh ka qenë me u rritë në familje ku ka pasë përzierje për shkak qe, qoftë se është individual, besoj që ka njëfarë efektimi kulturor?

**Mihane Salihu-Bala:** Për mua ka qenë interesant sepse kemi pasë shumë festa. Ka qenë knaqësia e të qenurit me festa. Në fakt nuk është bërë imponim, ky është ajo që duhet të thuhet. Nuk është bërë imponim çfarë të bësh, çfarë të zgjedhësh, cili do të jeshë. Ka pasë hezitime, gjithsesi, ka pasë frigë nga rrethi, do të thotë nga, nga mundësia për të manifestuar... Mirëpo unë do të them, megjithatë do të jem falenderuese nënës se nuk ka bërë presion. Dhe nuk ka diktuar kështu, "Gjithësesi duhet të jeni këta, ose ata..." Mirëpo i është përshtatë shumë mendësisë kulturore të rrethit. Edhe tani e kuptoj, gruaja ka pasë nevojë të mbijetojë edhe nuk na ka bërë presion.

Mua m'kujtohet kur ishin festat e ndryshme, ishte sidomos festa e bajramit, gjithë lagjja bënin bakllava, edhe nëna ime bënte bakllava. Vinin festat tjera, nëna ime bënte një ushqim më të veçantë, por nuk e bënte të madhe, kështu që ishte interesant. Ajo çka mbaj në mend unë është festat e shtatorit. Ajo festa kur bëhej buka e re edhe zihej gruri, dhe rrushi e krejt këto. Qatëhere neve na dukej intereant, "Ah gjyshërit do vien..." Edhe ishte interesant. Tek më vonë e kemi kuptuar që është traditë tjetër ajo. Për t'u bërë buka, për t'u ndarë me duar, për t'u zier gruri, për t'u zier, për t'u thyer arrat. Sepse për festë të bajramit nuk theheshin arrat, theheshin arrat për bakllava por jo për t'u vu në sofër, në atë kohë. Megjithatë unë jam rritë në Vranjevc, nuk kemi pasë gjithë tavolina si kemi sot.

Ajo që neve na është dhënë hapësira për t'hulumtuar, për t'njohur religjionin si religjion në përgjithësi, na ka ndihmuar, ose na ka mundësuar që në t'bëjmë zgjedhjen. Mirëpo jo fenë, kjo është ajo që e ndanë ndoshta më shumë. Për babën tim ka qenë, "Je shqiptar". Edhe aty përfundon bidesa. Do të thotë, "Është një Zot, janë të gjithë, kemi qenë kështu, jemi tani kështu..." Po në fund të fundit e ke traditën që është më e fortë se sa ndoshta marrja nga religjioni, ose nga feja e caktuar.



Unë shumë herët kam filluar të hulumtoj në religjion. Një herë për shkak të ateizmit dhe rebelizmit. Tani pastaj për shkak të interesimit, me i pa dallimet edhe përfrimet, ngjashmëritë brenda për brenda rrymave të caktuara fetare. Kështu që në shtëpinë tonë ka pasë, të gjitha librat kanë qenë pjesë e kulturës. Edhe pse jo shpesh herë të përkthyer në shqip. Kështu që debate ka qenë gjithmonë i nxehtë për religjionin. Jo për t'u kundërshtuar po për t'i parë, për t'i perceptuar mënyrat e ndryshme të shpjegimit teologjik n'atë kohë.

Kështu që kjo është unë pse kam filluar, edhe në fakt pse kam dashtë të njoh më tepër është kjo. Sot unë kam dy kalamaj, që janë të pagëzuar në Kishë. Mirëpo jo detyrimisht unë do t'i detyroj që ata t'mbajnë këtë zgjedhjen time. Unë do t'i ofroj mundësinë, edhe tash neve flasim, diskutojmë për religjione të ndryshme. Edhe pse janë të vegjël shumë, nuk u bajmë ndonjë, nuk kemi ndonjë praktikë që detyrimisht duhet të jenë në këtë, apo në atë. Sepse nëse prindërit e tyre shkojnë...

## Pjesa e Dytë

**Aurela Kadriu:** A ka ekzistuar një komuniteti i hebrenjëve në atë kohë?

**Mihane Salihu-Bala:** Komuniteti si i tillë ka qenë i konsoliduar si i tillë... ka pasë shumë pak në numër, mirëpo ne nuk kemi qenë pjesë e saj. Do të thotë për asnjë moment. Është më tepër ajo që është bartë përmes traditës edhe përmes gjërave të tjera, po jo në mënyrë të organizuar. Sepse nuk ka pasë sinagogë, nuk ka pasë ndonjë rabin. Nëna, familja nuk ka ekzistuar më e madhe, lidhje familjare. Do të thotë s'kanë qenë, s'ka pasë. Së vonmi kam, kam, kur kam filluar të hulumtoj kështu për, për kureshtje, e kam parë që ka qenë, mirëpo që shumë shpejtë në vitet '70 janë larguar, edhe ata që kanë qenë janë larguar.

Do të thotë në mënyrë të organizuar si të tillë s'ka pasë. Po ka pasë tek-tuk individ që kanë qenë pjesë e familjeve të ndryshme, qoftë përmes martesave, qoftë përmes trashëgimisë, qoftë përmes naj forme tjetër. Mirëpo shumë pak, ata që flasin shqip kanë qenë shumë pak.

**Aurela Kadriu:** A na tregon atmosferën e festave, shumë festave në familje që i keni pasë? Kujtimet...

**Mihane Salihu-Bala:** Po ta thashë unë, ishte diçka interesante. Vinte festa e bajramit, t'gjithë pjeknin bakllava dhe nëna ime bënte bakllava. Ishte ajo, po vinte festa tjetër, ne kishim një ëmbëlsirë më të ndryshme... Ose vinte festa e bukës së re, kishim grurë të zier, kishim rrush. Ishte interesant se mblidheshim, po jo për të thënë se ishte festa e caktuar. Unë maj n'mend dy momente tjera në familje, ceremonia rreth prerjes për vëllezërit, dhe momenti i të bërit grua (buzëqeshë). Ajo momenti i vajzës që fitonte një cikël ishte darkë e veçantë, ishte darkë e veçantë. Edhe këtë mbaj n'mend unë. Të gjitha motrat e kemi pasë një darkë të veçantë. Edhe vëllezërit e kanë pasë një darkë, drekë të veçantë, po jo ceremoni fetare, jo diçka tjetër. Kështu që ishte më tepër për t'a shënuar vetëvetën brenda për brenda familjës. Do të thotë ishte një e veçantë.

Edhe... Po, ëmbëlsirat me arra. Ato kanë qenë... por jo bakllavat, jo bakllavat. Edhe mollët me mjaltë, ato kanë qenë një moment tjetër që ne nuk e kemi... "Po sot kemi mollë më mjaltë dhe është ashtu..." Por për shembull në familjen time nuk është pirë vena, nuk është përdorë vena. Kështu që, do të thotë ishte njëfarë përzirje interesante, por jo vena si e tillë. Moshtë ndoshta po, por venë jo.

**Aurela Kadriu:** A na tregon tash periudhën kur keni hy në shkollë edhe qetë fazë tjetër të, të socializimit?

**Mihane Salihu-Bala:** Socializimi me rrethin ka qenë më i vështirë, sepse neve kemi qenë në shtëpi të nënës. Rrethi nuk të ka pranuar mirë. E në shkollë atëherë është dashtë të luftoj për mbijetesë. Duhet të mësoj më shumë, duhet baheshe ma e mirë. Deri te klasa e katërt, e pestë nuk ka pasë ndonjë presion ndoshta shumë të madh, përveç mënyrës të veshjes. Do të thotë ishim të gjithë fëmijë të klasës punëtore ose të papunëve të kohës. Gjithmonë po flas për të rriturit në Kodren e Trimave, nuk po flas për të rriturit në qendër të qytetit, që megjithatë, edhe pse nuk është larg, ka qenë një mënyrë tjetër e jetesës. Për shkak të kushteve ekonomike, për shkak të rregullimeve familjare, brenda për brenda familjeve raporteve që kanë qenë. Do të thotë është ajo që për t'filluar ndryshim shoqëror tek unë, sa i përket shkollimit, është viti i parë i shkollës së mesme.

Unë kam qenë gjimnaziste e gjimnazit, ish gjimnazit “Ivo Lola Ribar”, që tani është “Sami Frashëri”. Edhe është konsideruar si shkollë elitare, vërtetë për ata të talentuarit edhe për ata që kanë pasë lidhje me strukturat udhëheqëse. Mirëpo ka qenë një provim jo, po ka qenë ai rangimi sipas pikëve, sipas suksesit. Dhe unë kam pasë fatin të pranohem. Kam qenë në drejtimin e programerëve në atë kohë. Ka qenë gjenerata e parë që kemi qenë katër vjeçarë në shkollë, në gjimnaz. Edhe kam qenë në një klasë shumë të mirë, që ka pasë nga më të ndryshmit. Do të thotë nuk kanë qenë vetëm fëmijët e elitareve, po kanë qenë edhe të punëtorve të thjeshtë, profesionistëve të ndryshëm.

Edhe mbaj n'mend që për shkak që ka pasë emrin e madh si gjimnaz është dashtë të punoje shumë. Nuk ka ardhë në konsideratë të merrje një dysh, një tresh sepse e ke humbur... qëllimi ka qenë gjithmonë ma i mirë. Dhe unë kam pasë fatin të jem në një klasë shumë të mirë që ka pasë fëmijë nga familje të ndryshme, nga rrethe të ndryshme. Në klasën tonë ka pasë edhe nxënës që nuk kanë qenë vetëm të Prishtinës po kanë qenë edhe të rrethit të Prishtinës. Kjo njëfarë mënyre e ka bërë një lloj barazpeshë midis të pasurve dhe të varfërve.

Tash më kujtohet, më qeshet ndoshta (buzëqeshë) Viktor Hygo ka qenë ai, ka qenë njëfarë promotori për mua, me “Të varfërit”, librin “Të varfërit”. Jemi përjekë shumë, unë për fat të keq kam qenë gjeneratë që ka përjetu segregacionin etnik nëpër shkolla. Do të thotë kur shkolla veç fillon të ndahet, paradite shkon...

**Aurela Kadriu:** N'cilin vit keni hy n'shollë t'mesme, m'fal?

**Mihane Salihu-Bala:** '86 - '87.

**Aurela Kadriu:** Okej.

**Mihane Salihu-Bala:** '86, '87 po, sepse kam përfunduar në '90, '91, vitin shkollor '90, '91 kom përfunduar shkollën e mesme. Edhe kanë filluar ndarjet, segregacionet në baza etnike. Unë kam qenë pjesë e kohës kur janë bërë helmimet e nxënësve të shkollave fillore edhe të mesme. Do të thotë unë kam qenë në shkollën e mesme atë kohë. Edhe trazirat edhe '86, '87, '88, në... greva e minatorëve, e protestat e ndryshme. Kemi qenë pjesë e rritjes së tyre. Dhe unë mbaj n'mënd protestat e '81-tës, demonstratat e '81-tës. Sepse nuk na kanë leju të shkojmë në shkollë edhe është bërë zhurmë, edhe ka

qenë ai alarm i vazhdushëm, edhe ato helikopterët që kanë shku shumë afër tokës, aeroplanët e vegjël, a çfarë kanë qenë ato, të kohës. Ai gazi, helmi që është lëshu, gazi lotësjellës që është lëshu nga helikopterët e nga forcat e ndryshme.

Për shkak se protesta zhvillohej në qytet dhe për të ikur, iknin nga Vranjevci njerëzit, nga Kodra e Trimave. Policia vinte pas tyre, lëshonte gaz lotësjellës. Edhe ne kemi qenë, unë kam qenë shumë e vogël tetë vjeçe do të thotë, shtatë-tetë vjeçe. Po, mbaj n'mend shumë sepse bombardoheshim me informata të ndryshme edhe në atë kohë nga rrethi, nga njerëzit. Mbaj n'mend që studentët në atë kohë iknin. E tek familja jonë n'atë kohë kanë banuar shumë studentë të ndryshëm, kanë ardhë të familjarëve të ndryshëm, që kanë qenë prej rretheve të ndryshme, kanë jetuar tek ne.

Edhe mbaj n'mend ato bisedat e studentëve që ishin, "Jo është kjo keq, jo bëhet kjo keq, duhet të jetë republikë, jo s'duhet të jetë republikë, jo duhet t'jetë një formë tjerër, jo duhet t'jetë ajo..." Kështu që ky tregim i rezistencës ka qenë shumë herët në, në fëmijërinë time. Mirëpo, aktivizmin më të vazhdueshëm, më intensiv, e kam filluar në '88, '89.

Mbeta te Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve, por paraprakisht janë protestat e '86, '87, greva e minatorëve kur unë kam qenë në shkollën e mesme. Dhe nga mësimi iknim për të i'u bashkëngjitë protestës, mirëpo për shkak të rregullave strikte dhe sigurimit që ishte shumë i madh, në i'u bashkëngjiteshim protestave pas orarit të mësimit. Na u thonte që mos të i hiqim ato kecelet, atë uniformën që e kishim. Neve i thonim kecele, që të dallohej kush ishte nxënës kush jo. Mirëpo edhe me kecele, edhe pa kecele bashkëngjiteshim me turmën.

Me kujtohet protesta kur kemi qenë në qendër të qytetit edhe t'gjithë turma bërtiste "Kaqusha, Azem" ishte ajo parulla interesante. Kështu që këto janë fillet, edhe pastaj angazhimi im...

**Aurela Kadriu:** A keni pasë, m'fal, para se me dalë të angazhimi juj në Lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve, a keni pasë njohuri si nxanës të ri pse po protestohej? A veç i'u bashkojshnit për shkak...

**Mihane Salihu-Bala:** Jo, jo, jo, informimi ka qenë shumë i mirë. Vetëdija pse baheshin ato ka qenë më e lartë, mu për shkak të ndryshimeve që u bënë, që filluan të bëheshin në sistemin e ish-Jugosllavisë do të thotë... Ishte, ishte, ishim të informuar do të thotë, nuk ishim... Edhe pse mundësitë e komunikimit ishin më të kufizuara, shumë, shumë më të kufiuara se sa që janë sot, dihej pse bëhej. Sepse megjithatë bashkëbisedimet, lëvizjet e ndryshme ishin shumë aktive në atë kohë. Edhe politika ditore u bë pjesë e jetës. Do të thotë, ne fëmijët nuk ishim të përjashtuar nga ndikimi i politikës ditore.

Kështu që, disa me, disa me pasion, disa me dashje, disa për shkak se rastisnim të jemi në rrugë... Njifarë mënyre neve u bamë pjesë e protestave. Edhe rritja jonë nëpër rrugët e Prishtinës në këtë rast, nuk u bë në mënyrë graduale, po u bë shumë shpejtë e shpejtë. Sepse na nga fëmijë krejt të pa sherr, edhe të pa djallëzuar kushtimisht u bëmë pjesë e lëvizjeve, e ndryshimeve. Edhe pse nuk mund të thuhet se nuk kemi qenë të djallëzuar. Sepse unë flas për gjeneratën time, nga '81-ta ne jemi rritë me frigën se do të ketë luftë, do të ketë ndryshime, do të bëhet kjo, do të bëhet ajo. Ke qenë pjesë e, në mënyrë sistematike presionit shtetëror.

Edhe kjo njëfarë mënyrë t'bënë t'kesh një qasje tjetër fare. Sepse unë personalisht nga '81-ta jam rritë me idenë, me frigën që do të ketë një luftë. Edhe kjo luftë jo bëhet sot, jo bëhet nesër, jo do të bëhet

kështu, jo ashtu... Përcjellë për 20 vjet, nuk është pak. Do të thotë si fmi ti rritesh me idenë e frigës që do të ketë një luftë. Nuk e kemi menduar që do të jetë lufta sikur kjo e fundit që ndodhi. Mirëpo gjithmonë ka qenë ai imazhi i Luftës se Dytë Botërore që ty të ka përcjellë, qoftë në literaturë, qoftë në shkollë, qoftë në kujtesën kolektive të njerëzve. Dhe ajo friga e vazhdueshme t'bënë që ti në njëfarë mënyre t'ritesh nën presionin e saj.

Kjo ka qenë edhe pjesë e protestave, demonstratave '86, '87, '88. Sepse me fillimin e grevës së minatorëve t'gjithë ne që kemi qenë diku 15, 16 vjeçarë kemi pasë frigën e vazhdueshme se çfarë do të ndodhë nesër. Shtoja asaj faktin që unë kam pasë fatin të jem në rreth të njerëzve që kanë qenë studentë n'atë kohë, që në çarqet e studentëve është menduar më ndryshe. Kemi pasë mjaft, kushtimisht mjaft informatë. Po jo ndoshta informata të drejta, të duhurat, mirëpo një tërësi informatash se çfarë po bëhet, çfarë po zhvillohet, se si po bëhet. Edhe hezitimi i shqiptarëve që t'jenë pjesë e komplet sistemit ka bërë që ti të mendosh më ndryshe. Sepse megjithatë ke qenë i përjashtuar, ke qenë më ndryshe, nuk ke qenë pjesë e tërësisë të sistemit.

Shtoja faktin e dallueshmërisë shumë t'madhe gjuhësore e kulturore, kulturore ndoshta më tepër. Shtoja edhe faktin e ndryshimeve fetare që ishin, edhe pse nuk ishin të theksuara, ti si shqipar trajtohesh si musliman ose islamik. Edhe pse tek shqiptarët ka pasë edhe grupe tjera fetare, mirëpo kanë qenë shumë te vogla, minoritare. Ti trajtoheshë ndryshe.

Unë mbaj n'mend për shembull, ajo çka unë mbaj n'mend ndoshta që është e ndryshme nga perceptimi i kohës në Kosovë është udhëtimi nëpër vende tjera pa kufi, pa pasaportë. Mëgjithatë, Jugosllavia ka qenë një vend i madh, edhe ti ke marrë trenin nga Fushë Kosova ke shkuar në Krajinë. Ka qenë një tërësi, ka qenë një ndryshim. Mirëpo, në momentin ti kur e ke kalu Kosovën ka qenë një botë tjetër. Edhe pse ke qenë me tren, edhe pse ke qenë me autobus, ka qenë komplet ni botë tjetër. Ose hajde për ta bërë ndoshta një përshkrim tjetër.

Ktheheshe nga vende të ndryshme të Jugosllavisë, qyteti më i madh afër Prishtinës ka qenë ose Nishi, ose Beogradi. Edhe ballafaqimi i parë më Kosovën ka qenë në Merdare dhe Vranjevci. Do të thotë vjen nga një vend që ka një rrugë pak më të gjërë, ka... në këtë rast Beogradi, ka qenë një qytet më i madh, ose një qytet më i zhvilluar, edhe pamja e parë në Prishtinë është Vranjevci. Do të thotë ato shtëpitë me lloq të ndërtuara, me baltë, të rrethuara me ato rrethojat e atyre masave, e atyre fletave metalike, atyre "teneqeve". Një vrafëri ekstreme, që ishte një rrugë një orë larg, për shembull prej, prej... ose dy orë larg, nga një qytet tjetër.

Do të thotë dallimi ka qenë shumë i madh. Edhe pse, edhe prej Vranjevcit në qendër të qytetit që është 20 minuta të ecësh n'kambë, ka qenë dallimi shumë i madh. Ktu ke pasë në qendër t'qytetit ndërtesa shumë katëshe, "pallate" i quanim neve atëherë banesat, soliterat. Edhe 20 minuta më larg ka qenë vrafëri ekstreme. Kështu që këto dallimet kanë bërë, kanë bërë presionin edhe kolektiv edhe individual. Edhe këto ndryshime mua më kanë bërë tjetër fare do të thotë. Kam aspiruar, kam pasur dëshira për gjëra tjera mirëpo kam jetuar ku kam jetuar edhe...

Tek pyetja njohuritë, sa kemi pasë informacione, informacioni ka qenë i madh. Tjetër është se si është transmetuar, tjetër është se si është perceptuar, se si është pranuar ose si është përdorur ai informacion. Mirëpo si infomacion ka qenë. Ne anën tjetër duhet të theksohet edhe fakti që informacionet që neve i kemi marrë përmes mediave të shkruara n'atë kohë, gazetatat edhe

televizionet, kanë qenë të kontrolluara gjithsesi. Mirëpo ato informatat tjera kanë qenë të vërtetuara. S'ke pasë sikur sot lajme te rreme në çdo moment sepse ka qenë një filter që është bërë, ka qenë një strukturë, një sistem që e ka lëshu informatën të fundit. Mirëpo n'anën tjetër kanë qenë edhe informatat që janë bartë nga njëri tek tjetri, që kanë qenë përvoja jetësore, bindje, perceptime të ndryshme... Edhe kjo përzjerje e informatave bënë që t'kemi pasë informata të mjaftueshme. Mirëpo, jo çdo herë informatën e duhur.

Edhe kjo është veç kur fillon Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve. Unë kam qenë në shkollën e mesme. Kam dashur shumë të kyçem, edhe jam kyçur përmes lagjës, aktivistëve të lagjës që kanë qenë. Edhe për mua ka qenë interesant të merrje pjesë si shkollare e shkollës të mesme në një... të shkoj në familje, ose atëhere ishin ato dhomat e mëdha, ato odat, sepse neve s'kemi pasë në Prishtinë oda tamam, tipik. Po një dhomë pak më e madhe e mysafirëve dhe të ndëgjoje kur njerëzit provojnë të i pajtojnë dy familje. Reagimet e tyre, pranueshmëri ose mos pranueshmëria e një momenti të tillë të ndërmjetësimit ka qenë shumë interesante për mua sepse kam dëgju shumë rrëfime të ndryshme. Kam dëgjuar dy rrëfime për ngjarjen e njejtë, dy perceptime për ngjarjen e njëjtë, dy botë të ndryshme për të njejtën situatë.

Edhe atëhere ajo që m'ka ra më shumë n'sy, që mu m'ka bo më shumë përshtypje është se si familjet që kanë qenë në një hasmëri {bënë thonjëzat me gishta} ta quajmë kanë bërë jetën e tyre. Ai që ka qenë pjesë e, familja që ka qenë pjesë e viktimës, se si është trajtuar, se si është perceptuar nga rrethi, se si është ndikuar që t'merr hak, ose gjak n'anën tjetër. Edhe familja e dorasit se si ka jetuar. Shpesh herë ka jetuar me ndjenjë të fajsisë, të turpfit, të izolimit, të përqeshjes, të cytjes për të vazhduar krimin në vazhdimësi. Dhe interesant askush për këto gjëra nuk është folur. Mirëpo ka qenë ajo krenaria për t'marrë gjakun, ose për mos t'marrë, ose për t'a vu tjetrin në kushte të rrethimit komplet shoqëror, e shpirtëror, e fizik. Edhe kur është shpjeguar institucioni i besës për shembull. Ajo për mua ka qenë... Kam lexuar, kam ndëgjuar, mirëpo për ta parë se si funksionon vërtetë ka qenë interesant.

Edhe përpjekja e shumë njerëzve për të bërë diçka për veten e tyre, ajo ka qenë ndoshta kthesa më e madhe, edhe pse unë mbaj n'mend shumë takime. Jo shumë, po disa takime, që janë bërë në lagjen time, do të thotë te njerëzit që unë i kam njoftë, që kanë qenë pjesë e jetës tonë të përditshme, edhe sa i vështirë ka qenë ai proces. Do të thotë nuk ka përfunduar me një herë, e me dy, e me tre, po ndoshta ka qenë me dhjetë herë, ndoshta ka qenë tërë natën, tërë ditën, edhe me durimin, guximin edhe gatishmërinë e atyre njerëzve për të hyrë në një proces të tillë. Kjo ka qenë diçka që unë as sot nuk e harroj, në njërin anë insistimi i njerëzve për ti pajtuar familjet e në anën tjetër rezistenca aq e fortë për të mos u pajtuar.

Parë nga ky aspekt sot është, është ndryshe do e shpjegoja, mirëpo atëhere thirrshim në nacionalizëm, në atë që është më madhorja, në atë që ti duhesh sepse ne s'duhet të kemi kshtu... Është provuar të punohet edhe në aspektin social brenda për brenda familjes mirëpo kur ka dështuar ai element janë thirrë në atë madhoren, kombëtare, të përgjithshmen. Kjo ka bërë formësimin e... edhe pse unë nuk jam ndoshta personi ma i mirë për të bërë ndërmjetësimet po kjo është ajo qasja që ka shënuar jetën time ndoshta. E pastaj për të vazhduar me angazhimin brenda lagjës time, me gjëra të thjeshta, për ta pastruar rrugën time, për ta hjekur bërllogun, që bëhej, që u stivuan nëpër pjesë të

ndryshme të lagjes time për shkak se veç u bë sistemi paralel i jetës. U bë sistemi paralel i jetës në shumë sfera, në shumë fusha.

Në qytet funksiononte kompania që bënte mbledhjen e mbeturinave, ndërsa në Vranjevc nuk funksiononte, edhe njerzt shumë nga mosdija, shumë nga ngutia, shumë nga lodhja e tepërt filluan t'i depononin mbeturinat e tyre në pjesë të caktuar të lagjes. Edhe nëse kshtu figurativisht është tek trafoja, në Vranjevc, midis shkollës “Zenel Hajdini” edhe “Asim Vokshi”, bash aty ku bëhet degëzimi i disa rrugëve, filluan njerzit ta depononin, ta hedhnin, t'i hedhnin mbeturinat e tyre, bërlllogjet e shtëpive, të gjitha ato. Edhe mbajë në mend qe aty u bë një stivë shumë e madhe e mbeturinave edhe nuk kalohej asnjërin anë të rrugës. Shtoje atë që kur binin shirat, shpërlaheshin ato mbeturina edhe rrjedhnin në të gjitha anët si kanalizime, kur ishte nxehtë vinte erë e madhe. Mbajë mend që filluan organizimet e para të Lidhjes Demokratike në atë kohë, Lidhjes së Shkrimtarëve, Lidhjes Demokratike, ato forumet e ndryshme, ai organizimi shoqëror i sigurisë të lagjes, për ta rujtë lagjen nga sulmet e ndryshme policore, intervenimeve të ndryshme policore. Edhe aksionin e parë që unë mbajë mend që unë jam angazhuar edhe fizikisht, edhe shpirtërisht, edhe mentalisht është hekja e mbeturinave.

Ajo çka më ka bo përshtypje nga ajo ditë, nuk e mbajë në mend datën, kjo është fatkeqësi, është të gjithë pleq, të rinjë, fëmijë, gra, nuse, vajza, janë organizuar për ta pastruar lagjen e tyre. Njerzt në mënyre vullnetare kanë pruar traktorët e tyre, karrocet e dorës, ne ju thonim kolica ende në atë kohë, s'ishte karroca e dorës, me ato lopatat, me ato grabujat, furçit e ndryshëm për ta hjek bërlllogun nga lagjja. Mbajë mend sa patrolla të policisë që kanë ardhë me pa çfarë po bëhet sepse me të gjitha duhej të merrej një leje e veçantë se ishim më shumë se pesë veta, një grup, duhej të lajmrohej në polici. Nuk e di si është organizuar ajo pjesa teknike me shtetin, ajo procedura, po e di që ka pasë shumë patrolla të policisë që kanë ardhë me pa se çfarë po bëhet. Edhe për ta mbajtë mend që bënëin fotografi të shumta duke hekë bërlllogun. Kjo është ajo angazhimi im i parë, e pastaj kur veç filloi të, kur neve mbetëm jashtë shkollës, në vitin shkollor '91 - '92...

**Aurela Kadriu:** A muj me ju ndërpre veç edhe pak? Parullat kryesore të vitit '88, '86, '87, '88, cilat kanë qenë thirrjet kryesore?

**Mihane Salihu-Bala:** Jo, jo nuk i mbajë mend. Po mbajë mend “Kaqusha, Azem, jemi gati përherë” ka qenë një imitim i parullës nga socializmi i përtej kufirit. Ka qenë të bëj diçka me... nuk më kujtohet që është permend “Demokraci”. Nuk më kujtohet, ndoshta ka qenë ndonjë parullë, po “Minatorë jemi me ju, Trepça është e jona”, kta maj mend, “Kosova Republikë” ka qenë ajo nëna e të gjithave parullave, e slloganeve të kohës... “Të drejta, më shume të drejta” më kujtohet, '86 - '87 këto për afërsisht, ndërsa '81 është “Duam bukë”, këtë e mbajë mend nga përveç “Kosova Republikë”, është parulla qe unë e mbajë në mend është “Duam bukë”. A ka qenë e qëlluar a jo nuk do e diskutoj tani sepse është e kaluar. Po kto të viteve '87 - '88 ma tepër kanë pasë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit, të autonomisë së Kosovës në atë kohë. Edhe janë lidhë me përfaqësuesit politik të kohës, me ruajtjen e vlerave, po vërtetë nuk i mbaj në mend të gjitha veç asaj që ka qenë dominante, “Kemi të drejtë”, “I duam të drejtat tona, dhe “Kosova Republikë”. Nuk më kujtohet që ka pasë parullë me fjalën demokraci, nuk më kujtohet, ndoshta ka pasë por jo, mua nuk më kujtohet.

**Aurela Kadriu:** Në Lëvizjen për Pajtimin e Gjaqeve, ndoshta veç ishim ndalë pak më në detaje, kur jeni përfshi, pak më në detaje, mënyrën qysh jeni përfshi edhe nëse ju kujtohet ndonji rast specifik i pajtimeve të cilat keni marrë pjesë?

**Mihane Salihu-Bala:** Unë në mënyrë fizike kam shkuar përmes një kushëriri nga vija e nënës i cili ka qenë ish polic. Sepse i larguan policët e rinjë nga policia e Kosovës. Edhe ajo është ka qenë një aktivist që ka filluar të bëjë, në fakt pse u angazhuan policët që u larguan nga policia ishte për shkak se i njihnin njerzit, e njihnin terrenin, kishin një përgaditje më të madhe profesionale fizike për rast të mbrojtjes. Edhe unë përmes tij kam shkuar në takimin e parë. Nuk më kujtohen rastet e veçanta veç e veç, familjet e veçanta sepse vertetë kanë qenë shumë familje të cilat është provuar të kontaktohen. Unë mbajë mend që kam qenë një vëzhguese pasive ndoshta në fillim, jo për të folur sepse s’kishim vend, neve ishim veç për t’iu dhënë përkrahje më tepër.

Mbjaj mend një familje, nuk e di me emër tani, është shumë keq, që e fali gjakun e djalit, mirëpo pse e mbaj mend atë rast është se kishin ndodhur dy - tre vrasje të njëpasnjëshme për një kohë shumë të gjatë. Ishte një konflikt ndoshta 30 vjeçar, nuk ishte i ditëve të fundit, sa që ai që e fali gjakun i binte të falte gjakun e dikujt që nuk e kishte takuar kurrë në jetë, ky është momenti që unë e mbaj mend që më ka bërë shumë, shumë, shumë përshtypje është që njerzit provonin ta kalonin vetën për dikun që nuk e kishin njoftë fare. Do të thotë a ishte gjyshi, a ishte xhaxha i babës, a vllau i babës nuk mbaj mend, po për dikë që nuk e kishte takuar në jetë. Ndërsa momentet më të vështira është kur pas hezitimeve të mëdha e pas punës që bëheshin, nënat merrnin përsipër të fal gjakun e fëmijëve të tyre.

Ai është një moment në atë kohë nuk e kam menduar asnjëherë si kapërcim të vetvetës, po të thashë ishte ajo idea po e falnin për një gjë madhore që mos të ketë vlla-vrasje ndër shqiptarë e krejt kto. Mirëpo më vonë, kur kam filluar ta analizoj, kur unë kam ardhë në situatë të jem nanë, ajo është e pashoqe. Ajo ka qenë një moment ndoshta që në mënyrë të pavetëdijshme neve kemi kapërcyer etapa të tëra të zhvillimeve shoqërore. Me gjithë vullnetin e mirë, me gjithë dëshirën që të mos jetojnë me frikë, ti kërkohet një nëne ose një babe që ta fal gjakun e fëmijut, vërtetë ka qenë guxim. Sot nuk e besoj që do e bëja diçka të tillë ose do të kërkjoja me aq ngulm të tillë sa që është kërkuar në atë kohë. Mirëpo, njerzit kanë gjetë forcën për të bërë këtë veprim.

**Aurela Kadriu:** A na tregon mandej për ku metëm ma herët para se me ju ndërpre, për të ‘90t-at për jetën paralele?

**Mihane Salihu-Bala:** Eh, jeta paralele është të thashë viti shkollor ‘91 - ‘92 nuk filloi. Të gjithë shoqëria ishte e humbur. Për çdo ditë ndëgjohej se shokët e klasës time, shokët e gjeneratës iknin nga Kosova për shkak të mobilizimit të dhunshëm ushtarak, edhe njerzt për t’i shpëtuar mobilizimit të dhunshëm ushtarak filluan të iknin, sidomos djemtë në mënyrë masive. Një lloj vdekje e dyfisht shoqërore, edhe fizike edhe shpirtrore, sepse njerzt që i njihni filluan të ikin, qyteti pothuajse u boshatis, lagjja ime në këtë rast, nga njerz që unë i njihja, nga shokët dhe shoqet e gjeneratës, por më shumë nga shokët e gjeneratës. Nuk filloi viti shkollor në shtator të ‘91-tës, dhe nuk dihej çfarë po bëhej...

**Aurela Kadriu:** Ju ende nuk e kishit përfunduar shkollën e mesme?

**Mihane Salihu-Bala:** Jo unë e kisha përfunduar shkollën e mesme, isha regjistruar si studente e Universitetit të Prishtinës në atë kohë.

**Aurela Kadriu:** Në cilin fakultet?

**Mihane Salihu-Bala:** Atëherë kam qenë e regjistruar në fakultetin teknik, drejtimi i energjetikës, elektro-energjetika, elektros. Edhe përgaditjet që janë bërë për të filluar mësimi në shkollat, në sistemin paralel në shtëpi private, më kujtohet shumë mirë, kemi filluar vitin akademik në shkurtmars të '92-tës. Edhe për shkak se ekzistonte shkollat e mesme edhe fakultetet dolën nga sistemi shkollor, u bënë sistemi paralel, shkollat fillore ende punonin. Edhe u bë një organizim i tillë që paradite shkonin shkollarët e shkollave fillore ndërsa pasdite shkonin disa nga shkollat e Prishtinës, sidomos në Vranjevc, shkonin fakultetet, studentët e fakulteteve të ndryshme.

Mirëpo kjo nuk u bë e mjaftushme, nuk kishte hapsirë të mjaftushme dhe pothuajse për një kohë shumë të shkurtër u hapën shkollat shtëpi. Një moment shumë i veçant është që profesorët e Universitetit të Prishtinës i hapën dyert e shtëpive të tyre për ti mbajtur ligjeratat me studentët e tyre. Kjo është një moment që jo shpesh herë e flasim, jo shpesh herë e përmendim, mirëpo fillimisht profesorët e Universitetit të Prishtinës i hapën dyert e shtëpive të tyre. Njerzit e vullnetit të mirë i lëshuan shtëpitë e tyre, me të gjithë ato vështirësitë që i kishin, disa ishin të ndërtuara, disa nuk ishin të renovuara, po filluam në blloqe, blloka të kuq me dërrasa përmbi, do të thotë ulëset ishin dërrasat edhe bllokat.

Mbaj mend që ligjeratat ishin në pjesë të ndryshme të qytetit, varësisht ku kishin mundësi të bëheshin edhe brenda ditës shkonim nga Dragodani deri në Bregun e Diellit edhe në "Xhemajl Ibish", rruga "Xhemajl Ibish", do të thotë ishin tre vende të ndryshme në qytet që ishte një llojë maratone për të mbrii prej një ligjrate në ligjeratën tjetër. Edhe presioni policor, se u shtun masat e policisë, e sigurimit, policia ishte shumë aktive, edhe ku do që shihnin dy-tre veta i ndalonin, sidomos të rinjë. Unë tani bëj shaka me kohën them ajo periudhë është që unë i kam mësuar të gjitha rrugicat e Prishtinës. Sepse për të ecë nëpër rrugët kryesore të Prishtinës nuk ka qenë fort punë e mençur, dhe i kemi mësuar të gjitha rrugicat e Prishtinës, jo veç ne që ishim nga Prishtina po edhe ata që erdhnin nga pjesët e tjera të Kosovës, nga qytetet tjera. Do të thotë studentët e asaj kohe, i kemi ditë të gjitha rrugicat e Prishtinës, ka qenë shumë një situatë interesante sepse në kushte normale nuk do t'i mësonim. Edhe u bë zhvendosja e studentëve nëpër pjesët periferike të qytetit, do të thotë konviktet nuk ishin më funksionale për studentët shqiptar, nuk ishin aty. Objektet e universitetit nuk kishin studentët shqiptar kështu që jeta e studentit shqiptar bëhej në periferi.

Bënë masa shumë të rrepta sigurie, në masa shumë të rrepta të represionit policor në atë kohë. Shtoja kësaj edhe varfërinë e skajshme që filloi të mbretëronte, shumica u detyruan t'i lënë studimet, do të thotë për të ikur, për të mbijetuar. Edhe kështu fillon në fakt, kështu fillon edhe gjenerata e dytë e emigrantëve nga Kosova. Kjo është kthesa më e madhe që u bë edhe ata që patën mundësi ekonomike dhe që patën një mënyre apo tjetër gjetën mundësinë dhe dolën jashtë.



Shumë shokë edhe shoqe të miat të shkollës së mesme që kanë qenë vërtetë shumë nxënës të mirë dhe janë bërë edhe atje tani ku janë njerz të shkolluar, të suksesshëm, i kanë braktisë studimet dhe për të shpëtuar kokën kanë ikë. Ne që kemi mbetë, kemi mbetë jo për idealizëm, jo të gjithë për idealizëm, po për shkak të rrethanve, kushteve, të cilat kemi qenë. E mira e krejt kësaj është që ne kemi mbijetuar dhe kemi vazhduar edukimin dhe shkollimin tonë në ato kushte. Edhe pse sot ndoshta duket që... Pasë parasyshtë që ti nga një univerzitet kthehesh në një fakultet, në një dhomë me dërrasa, ku s'ka as kushte elementare për studime ose për të mësuar, megjithatë duhet të jemi falenderues për mundin e mësimdhënësve në plan të parë.

Në aspektin shoqëror na ka kushtuar shumë, si tërësi kulturore, mirëpo falë asaj vazhdimësie të shkollimit edhe me kushtet e rënda që ishin, ne jemi sot këtu ku jemi, sepse po të ndërprej shkollimi, edhe po pritshin që do bëhet një zgjedhje qoftë ekonomike qoftë politike tjetërfare, do kishim një, do kishim gjenerata të tëra të analfabetëve që do të kishte pasoja shumë të mëdha. Mirëpo me ato kushte që kishim, me ato mundësitë që kishim ne provuam të dëshmonim që mund t'ia dalim ndryshe. Me gjithë dyshimin që mund t'i bëhet nga kjo perspektivë unë ndaj mendimin që sistemi paralel i shkollimit ka krijuar një vazhdimësi të mbijetesës. Edhe përkundër dëmeve që na është bërë si shoqëri sepse i gjithë entuziazmi i atyre të rive për t'u shkolluar, për t'u edukuar, për t'u arsimuar, për t'u bërë profesionist ngec në pamundësitë të kushteve të shkollimit. Mirëpo tani ndaj mendimin që ka qenë zgjedhja e vetme e mundshme e mençur e kohës.

**Aurela Kadriu:** A na tregoni për protestat studentore, unë e di që keni qenë pjesë...

**Mihane Salihu-Bala:** Protestat studentore... protestat studentore, po duket krejt jeta më shkoi rreth studentëve dhe protestave studentore. Protestat studentore nuk kanë filluar ne '97-tën, kanë filluar në '92v- '93-tën. Unë mbaj mend që edhe atëherë kam qenë aktive në '92 - '93-tën në organizimin e atyre protestave të pakta në numër dy-tre sa ishin që kërkonim kthimin e objekteve shkollore, të drejtën e sovranitetit të univerzitetit, të drejtën elementare të njeriut për shkollim e kto gjëra, por çfarë mbaj mend është represioni policor, dajakun që e kemi hangër gjatë atyre protestave. Edhe një lloj jo koncenzusi shoqëror, po një lloj heshtje e përnjëherëshme e protestave në '93-tën, do të thotë nga '93-ta, '97-ta, asnjë përpjekje për të bërë protestë sepse represioni ishte shumë i madh, në anën tjetër ishin luftrat në rajon e në anën tjetër ishte pabarazia fizike, ushtarake e popullatës shqiptare në Kosovë karshi të tjerëve.

Edhe ajo, kushtimisht ajo pritje që mjaft u bë a e din edhe do bëhet më mirë sepse pavarisht gjykimeve që mund t'i kemi sot, falë guximit për të iniciuar lëvizjen paqësore në Kosovë, ne kemi mbijetuar. Ndoshta dëshira e njerzve ka qenë që të bëhet luftë më herët, mirëpo neve nuk kemi qenë të gatshëm as për të bërë luftë, as për të bërë rezistencë më shumë, jo rezistencës të armatosur, jo të ati llojit, të ati formatit që kanë qenë, në të cilat kushte kanë qenë shtetet rreth nesh, ose ish-Jugosllavia, ose ajo pjesë e Jugosllavisë që mbet më vonë. Forma e rezistencën paqësore ka pasë dy gjera të mira, është testu durimi i njerzëve edhe është mësuar mënyra e mbijetesës në kushte jo normale.

Edhe pse tash ndoshta nga kjo perspektivë do të thotë, ndoshta ka qenë më mirë të bëhet më herët, unë nuk e ndaj mendimin që është dashtë të bëhet më herët ose që ka mund të ndodhë ma herët sepse po të ndodhte lufta e formatit të '98 - '99 që ishte në Kosovë, të ndodhte në '93 - '94 gjykoj që pasojat do të ishin shumë më të mëdha në njerz, do të kishte shkatërrim shumë, shumë më të madh edhe për sigurt një milion njerz nuk do të ishin më. Jo veç të zhvendosur, jo veç të zhdukur, po nuk do të ekzistonin fare sepse kapaciteti ushtarak i ish-Jugosllavisë siç ishte shumë i madh në atë kohë për një vend sa ishte territori i Kosovës do të thotë. Shtojë atë që gjithë do bëheshin kundër një njësie të vogël siç ishte në atë kohë Kosova, pasojat do të ishin shumë, shumë më të mëdha. Jo që nuk ka pasë lufta pasoja, mirëpo ndaj mendimin që instalimi i mendsisë të rezistencës paqësore ka ndiku, ka pasë efekt pozitiv edhe ndikim pozitiv në ruajtjen e jetës së njeriut në rend të parë.

Ndërsa gjërat tjera kanë mund të kalojnë edhe me kalvarë të ndryshme, me sakrifica të ndryshme. Në një mënyrë shtyerja e, mos realizimi i marrëveshjes që u prezentua nga *Sant'ediggio* për arsimin, prolongimi i saj i pafund, pamundësia për të arritur një mirëkuptim, për t'u realizuar ajo marrëveshje, ajo, ajo, ai propozim në fakt bënë që unë të kyçem në, të kyçem në lëvizjen studentore në Unionin e Pavarur të Studentëve jo në lëvizjen studentore po në Unionin e Pavarur të Studentëve në '96-tën, po tani si studente e fakultetit filozofik sepse ndërkohë unë ndërprejta fakultetin e elektros për të shkuar ne Zagreb, mirëpo edhe atje fillio lufta dhe unë zgjedha të kthehem në Kosovë.

**Aurela Kadriu:** A na tregon pak për këtë periudhën, qysh e ke interpretu kur keni shku atje si...

**Mihane Salihu-Bala:** Është interesant, unë në vitin shkollor '90 - '91 kam aplikuar në Zagreb, në kriminalistikë. Mirëpo për shkak se diploma ime kishte qenë me Republikën e Kosovës, dokumentat e mia nuk janë trajtu atje, po kanë shku në Beograd. Edhe unë nuk jam pranuar në Zagreb edhe kam marrë vesh shumë vonë që dokumentat e mia janë, aplikacioni, kërkesa ime është në Beograd, sepse në mënyrë arbitrare nga Kosova janë transferuar në, siç kanë qenë dokumentat nga Kosova janë transferuar në Beograd.

Ishte një vështirësi materiale, ekonomike shumë të mëdha në familjën time në atë kohë edhe përmes disa miqve më ofrohet mundësia si studente me korrospodencë në Zagreb. Edhe unë pranoj të shkoj të shof për një semestër edhe mbes atje nga '93-ta, nga shtatori-tetori i '93-tës në marsin e '94-tës. Ishte kulmi i luftës, ishin gjëra që filluan që çdo gjë të bëhet më e rëndë edhe në pamundësi për të mbetur në Zagreb ose për të vazhduar tutje unë kthehem tek familja, edhe ishte një atmosferë shumë e rëndë nga dëshira për t'u shkolluar, për të bërë gjëra të mira. Edhe mbeta në shtëpi. Për t'u kthyer në fakultetin e elektros nuk i kisha mundësitë materiale se megjithatë kërkonte libra, ushtrime, të gjitha këto. Neve veç u bamë në shtëpi edhe dy studentë, edhe vllau ishte student tani edhe motra e përfundoi shkollën e mesme dhe ajo do të regjistrohej në fakultet kshu që duhet të shihnim çfarë, cilat janë prioritetet.

Plus që gjendja ekonomike u rëndua shumë edhe një ditë prej ditësh nëna më vë një ultimatum sepse në atë kohë të martoheshe ishte në modë, "O fakultet, o bë zgjedhje". Edhe ashtu kam vendosur, kam marrë dokumentat dhe kam dalë në qytet. I kam pa ca student që po shkojnë ka drejtimi i rrugës së

Dubrovnikut dhe unë kam shku pas tyre edhe kam has fakultetin filozofik. Kshtu jo me ndonjë zgjedhje të veçant po hajt t'shof çfarë po, cila është mundësia. Kam hy në sekretarinë e fakultetit edhe i kam pyt, “Kshtu, kshtu, jam e interesuar të regjistrohem, a ka mundësi?” Po flasim për prillin e ‘94-tës.

Më kujtohet një puntor që ka qenë, Kastrati mbiemrin, një plak shumë i mirë tha, “Po ku ke qenë ma herët?” Ashtu me një të qeshur, thashë, “Rrugëve”. Kështu pa ndonjë kompleks. Po tha, “Qysh me t'pranu?” Thashë, “Po unë e kam një indeks të fakultetit të elektros”, “E po mirë hajde, po ti pse s'po shkon ta krysh fakultetin atje?” S'ka ma fjalë aty edhe ma mundësuan qe ta bëj kalimin nga një fakultet në fakultetin tjetër, do të thotë jo nga Zagrebi të kthehem po nga këtu. Edhe shkoj në shtëpi i them nanës, “Më pranuan në fakultet”. Edhe mirë ashtu, mirë e ngrata as s'besonte që bëhej ajo punë, mirëpo ishte ultimatumi i saj, o, o, s'ka të mesme. Edhe hera e parë që kam shkuar në fakultetin filozofik për mua ka qenë...

**Aurela Kadriu:** Në çfarë drejtimi?

**Mihane Salihu-Bala:** Në pedagogji, në drejtimin e pedagogjisë. Ligjeratën e parë që kam shkuar unë do të thotë edhe pak ditë fillonte afati i prillit, edhe shkoj unë ligjeratën e parë tek landa e Etikës. Edhe profesori, tash ia gjej emrin ose ndërkohë më kujtohet... Mavriqi, profesor Mavriqi. Ishte i pari që unë takoja nga profesorët edhe ishte një sallë, një dhomë tek një dyqan në një rrugë qorre. Nja 150 studentë, 200, sa ishin studentët e vitit të parë dhe të dytë se i përgaditshin për afatin e provimit të prillit, për afatin e prillit. Edhe hy unë, më kujtohet kam pas flokë shumë të shkurtra, jo krejt të rruara atëhere po shumë të shkurtra, e veshur me të zeza, nuk kam qenë kaq e plotë sa jam tani, kam qenë shumë ma e dobët. Edhe profesori Ramush Mavriqi fillon të flet për Emanuel Kantin dhe ligjeratën e parë që e kam ndjek është ajo ligjeratë edhe askush s'bënte pyetje, askush s'fliste as nuk pipëtinte.

Në ndërkohë e ngris dorën edhe e bëj një pyetje dhe më thotë, “Ti kush je?” Edhe unë i them kshtu, dhe, “Çka ke ardhë?” Them, “Kam ardhë me t'njoftë cili jeni, me pa cili është libri edhe me hy ne afatin e provimeve, në provim në prill”. Tha, “Ti në afat të provimeve në prill s'vjen në shprehje”. Edhe kështu ka filluar, unë vërtetë e kam kryer provimin Etikë në afatin e prillit sepse kam shku në shtëpi kam lexuar. Edhe më kujtohet dita e provimit kur kemi hyrë edhe për shkak të kushteve që ishin profesori vënë tre-katër studenta dhe një pyetje, ti e din, ti s'e din, ti e din, ti s'e din, dhe ashtu kalonin do të thotë, bënte tre pyetje, kush i dinte mirë, kush s'dinte... Edhe dikur u lodh edhe m'tha, “Eja ti”. Më vuri aty perpara dhe filluam të flasim ne një orë e gjysmë, tha “Vjen afatin tjetër”. Tha, “Gjashtë”. Ani gjashtë, gjashtë, qashtu diçka s'e kisha fort problem. Dhe folëm një orë e gjysmë dhe mori indeksin e vëji notën dhe unë nuk e diskutoj atë punë, gjashtë, gjashtë. Tha, “Eja afatin tjetër një notë më të lartë”. Unë s'e kisha hallin e notës.

Edhe e marrë indeksin unë, dola, më kujtohen studentët thanë na i bëre sherrin se tash krejtve kanë me na rrëzu në provim, ishte ajo shumë interesant. Marrë unë indeksin, shkoj në shtëpi, nuk e hapi gjatë rrugës ta shof çfarë note është dhe i them nënës ja e kam dhanë, dhe tha “Çka morre?” Gjashtë, ajo e hap thotë “Po s'është gjashtë, është nëntë”. Jo more gabim je t'u e pa ti, dhe e kam marrë një

“nëntshën” e parë në fakultet. Edhe kështu ka filluar, unë kam përfunduar provimet e tre viteve për më pak se një vit akademik edhe kështu jam kyç në Unionin e Pavarur të Studentëve. Atëherë kryetari i Unionit të Pavarur të Studentëve për fakultetin tonë ka qenë Dugolli, Bujari edhe kështu jemi njoftu edhe unë jam aktivizu rreth Unionit të Pavarur të Studentëve. Edhe kur i ka fituar zgjedhjet Bujari të jetë kryetar i Unionit të Pavarur të Studentëve në Univerzitetin e Prishtinës, atëherë më ka ftu edhe mu që të jem bashkpunëtore e tij, edhe kështu jam kyç në Unionin e Pavarur të Studentëve.

Ndërsa tek idea e paqësorës ka qenë pak problematike të kyçem se megjithatë ishte koha, nuk kishim shumë njohuri. Unë për vete nuk kam pasë për Ghandizmin njohuri derisa jemi takuar, jemi mbledh si grup, deri sa Albin Kurti ka qenë, është ardhë. Atëherë ne kemi filluar të mësonim edhe për Ghandizmin, edhe për paqësorët, pacifizmin, mirëpo pacifizmi që ne e kemi njoftë ka qenë ky vendori, i sistemit paralel, i rezistencës pasive, paqësore, po jo i Ghandizmit ose diçka tjetër, ose të ndonjë fushe tjetër. Edhe kështu kemi filluar, unë kam qenë antare e Kryesisë të Unionit të Pavarur të Studentëve, kam qenë e vetmja gocë në atë kohë aty. Edhe pastaj janë bashkangjitur edhe kolege tjera edhe kolegë të tjerë.

Përgaditjet për protestën e 1 tetorit të '97-ës kanë filluar më herët. Ka qenë dëshira, ka qenë frika, ka qenë mllefi edhe ka qenë droja se çfarë do bëhet. Ndërsa 1 tetori është diçka që është mbet aty në kokë dhe pritjet, frika edhe mbijetesa, se çfarë do bëhet. Jo për të folur për 1 tetorin po unë do të flisja për një moment tjetër. Jo për neve studentët, jo për neve që ishim kuadër të kryesisë, unë s'kam qenë në këshillin organizativ por kam qenë pjesë e kryesisë. Po për gatishmerinë e të gjithë njerzve ta mbështesin lëvizjen studentore, të jenë pjesë e 1 tetorit. Jo 1 tetorit si datë, po unë e konsideroj 1 tetorin si institucion tani, atëherë ka qenë një datë, veç një moment për mua, po tash është një institucion për mua.

Gatishmëria, vullneti i njerzve të jenë pjesë e saj, edhe të jesh pjesë e turmës, të gjithë atyre studentëve që për simbolikë e patëm zgjedhur atë këmishën e bardhë ta kemi të veshur, është një moment jo i krenarisë, po i formësimit asaj shenjës, atij tatuazhit, jo me ngjyrë po me emocion, me të gjitha ato gjërat që e përfshijnë momentin. Kshtu që, 1 tetori është jetë në vete, nuk është veç rrëfim në vete, nuk është veç datë, nuk është veç ditë, por është jetë në vete. Po ma shumë e mbaj mend një ditë para 1 tetorit, ajo është një moment më i madh për mua. Kur ti e vënë jetën tënde në, e kthen filmin e jetës tënde çdo moment se e din që nesër është një ditë shumë e madhe edhe nuk e din a përfundon jeta jote...

## Pjesa e Tretë

**Mihane Salihu-Bala:** Për mu me rëndësi është një ditë para 1 Tetorit, kur veç përfundam për të gjitha ato dhe vendosëm të shkonim në shtëpi, që të vinim nesër më herët në mëngjes edhe ti bën një, një reflektim jetës tënde. Edhe unë në atë kam qenë 24 vjeçe edhe krejt jeta ime zhvillohet për dy, tre orë në filmin, në kokën time edhe çfarë kam bërë, çfarë më kam mbetë pa bërë, çfarë do të doja të ishte ndryshe. Sepse e nesërmja ishte një ditë që nuk dihej si do përfundonte, a do kthehesh në shtëpi

a s' do kthehesh në shtëpi apo si do bëhej? Por në këtë rast une do të doja të falenderoja në veçanti të gjitha nënat edhe baballarët që kanë gjetë forcë t'i përkrahin fëmijët e tyre dhe t'i lëshojnë të nesërmen të shkojnë në protestë.

Sepse më kujtohet nëna ime, të tre studentët, katër studentë. Ne vërtetë u veshën me këmisha të bardha edhe dolën edhe ajo thotë, "Shihemi" asgjë tjetër. Do të thotë si e ka përjetu ajo (qeshë), "Unë kam me shku, unë e kam për obligim për të shku në protestë". Po ajo që mbet në shtëpi edhe tek më vonë kur tha, kur na patë treguar, tha unë vërtetë jom përshendet për herë të fundit me juve atë ditë. Ëë, po si s'e kemi, nuk e kemi përceptuar sepse ishte ajo, "Kam për të shkuar në protestë!"

Emocioni para 1 tetorit ka qenë ndoshta shumë ndoshta shumë më i madh se sa gjatë tetorit sepse veç momentin kur kemi filluar marshin e protestës, panika, frika, droja, stresi, u topitën, u bënë 1 edhe u bë çfarë u bë tani jemi këtu. Ndaj mendimin që e tëra, e tërë ngjarja e asaj dite është një roman në vete, unë as nuk e kam forcën e as dëshirën ta, ta, ta vëj në spikamë. Sepse ndaj mendimin që kam bërë veç një pjesë të obligimit tim moral edhe shoqëror, ma tepër moral në atë rast edhe kam dasht me njëfarë mënyre të jem vetja ime, t'jem besnik asaj çfarë kam bërë thirrje.

Për asnjë moment nuk kam mendu të ik nga protesta por kur ka kërsit dajaku edhe unë si të tjerët kam provuar të mbijetojë. Do të thotë, nuk është ma, nuk mbetëm ma, nuk mbeti ma vend që t'a mbanim resistencën ashtu si e kemi planifikuar. Po duhet të gjindesh si bahet rrethana, momenti. Në kujtesën time kanë mbet zërat edhe thirrjet edhe piskamat e studentëve duke ikur shpateve të asaj rruge në Velani. Jo mo rrugë po duke provuar të ngjitej shpateve të ndryshme.

Edhe gatishmëria e njerëzve m'i hapë dyert e tyre, për të futë studentë mbrenda, duke pasë parasysh që mund të bahet veç dhjetë minuta dhe të vijnë forcat policore dhe ta demolonin shtëpinë. Kjo është, kjo është jashtë çdo përceptimi të mobilizimit shoqërorë. Sot po të ishte situatë e njejtë nuk e besoj që njerzit as une nuk do të hapja derën aq lehtë për gjithë ata njerëz. Mirëpo, gatishmëria e njerëzve edhe besimi që e kanë pasë në njerëz në lëvizjen studentore, jo ndoshta në ndonjë individ veç e veç mirëpo në gatishmërinë ajo është diçka që unë nuk e kam has mo askund. As gjatë punës, as gjatë studimeve, as gjatë përvojës jetësore.

Edhe pas gjithë atij rrebeshi gjërash kur veç fillon ajo, ajo, ajo heshtja absolute pas krejt asaj ta gjejë një telefon e ta lajmërojë nanën tande që gjallë, e je mirë. Edhe atëherë e di që për nënën time ka qenë, edhe për nanën edhe për babin në fakt për te dytë momenti ma i vështirë i tyne sepse vëllau dhe motra ikën, mrrinën në shtëpi ndërsa unë jo. Edhe ajo pritja se tash kur do të na lajmërojnë që është dikun ose ka mbetë ose, se informatat ishin të ndryshme tani dhe kur po na a je mirë veç a je mirë, kaq mjafton a din, s'është me rëndësi ku je, veç a je mirë dhe a je gjallë. Do të thotë vet fakti që lajmërohem e dijnë që nuk jam në brug, nuk m'kanë arrestuar edhe që jam gjallë mjafton. Do të thotë të kënaqesh veç pse e dëgjon zërin e dikujt.

E ky ishte ai momenti interesant edhe unë kam pasë fatin për gjatë gjithë kohës sa jam larguar nga aty, të përfundoj në një familje shumë, shumë, shumë të mirë, që ka strehuar shumë studentë. Edhe më kujtohet që zonja e shtëpisë më ka dhanë një këmishë për ta hjekur atë këmishën time të bardhë

më ka dhanë të zezë. Është simbolike dhe interesante. Unë kam kaluar atë ditë pasditen edhe me atë këmishë të zezë kamë zbritur nga Matiqani nëpër qytet për të pritur edhe pse nuk kam, atë nuk kam mbri në shtëpinë time, kam fjet te shtëpia e një shokut tim, tek familja e tij në fakt.

Mirëpo, ajo ngjyra e bardhë tanimë është veç një pjesë e pëlhurës në kokën time që është mbetë edhe kjo, kjo është një moment tjetër. Zhvillimi i Lëvizjes Studentore Paqësore, forma që merr më vonë, aktivitetet, protestat që bahen ma vonë, janë një vazhdimësi po jo më pak rëndësishme. Sepse megjithatë prej secilën prej tyre është bërë punë, secilën prej tyre është bërë angazhim maksimal e të arrihet aty ku kemi dashtë ne që të kthehem në Univerzitetin e Prishtinës.

Mirëpo, secila protestë tjetër ka qenë një përvojë tjetër e re po nuk ka qenë ajo frika e të parës. A unë mbaj në mend njëren prej protestave që është bërë me ngritjen e atyre fletave, librave ku mua më ka rreh një polic. Edhe unë kam fotografi edhe nga polici që m'ka rra mua dhe unë se kam qenë e lënduar, e ka bërë një gazetë, një fotograf Italian Carvalio mbiemrin nuk më kujtohet, Pier, Pier nuk e di... Po kam një fotografi dhe ai polici që m'ka rra ka qenë relativisht i madh, ashtu dhe bajagi i bukur, po është një detaj shumë interesant do të thotë i kësaj.

E pastaj kështu, unë përfundimisht jam larguar nga Unioni i Studentëve në nëntor të '98-tës. Do të thotë, kam filluar kam gjetur një punë, jam punësuar. Se vërtetë tani ma ish, ishte një situatë tepër e rëndë edhe gjendja ekonomike e familjes u rëndua shumë edhe duhej bëhej diçka. Mirëpo, gjatë kohës unë kam qenë e angazhuar në Lëvizjen e Pavarur të Studentëve kam pasur fatin e jetës, fatin ma të madh ti takojë, të takojë mikeshën time të re tani nga Gratë në të Zeza, Žene u Crnom, edhe profesorin Rino Belek që për mua kanë bërë një ndryshim të madh në jetë. Edhe falë tyre unë jam njohur me, me grupin e Grave në të Zeza, me qasjen e feminizmit aktiv.

Tani edhe nga '97-ta unë jam pjesë, anëtare e aktiviste e Rrjetit të Grave në të Zeza, Grave në të Zeza, në të gjithë botën. Për fat te ne këtu në Kosovë nuk kemi edhe nuk kemi provuar ta instalojmë, as të organizohemi si formë e tillë për rrethana të caktuara, për shkak të rrethanave të caktuara edhe shoqërore edhe politike edhe ekonomike edhe morale. Po unë nga ajo ditë jam pjesë e Grave në të Zeza dhe mundohem aq sa mundem në mënyrë vullnetare të jem pjesë aktive e rrjetit.

**Aurela Kadriu:** E përmendët më herët që e kishit, që '97-tën nuk është shku ashtu si është planifiku, a na tregon qysh e keni planifiku paraprakisht rezistencën, qysh e keni projektuar ju...

**Mihane Salihu-Bala:** Unë kur thashë nuk u bë ashtu si e patëm paramenduar është sepse ne përgaditjet që i bëmë është në raste të intervenimit të policisë gjithë të të ulëshim edhe do të rrinim aty do të qëndronim s'do lëvizim do të bëheshim sikur ata gurët. Mirëpo nuk ndodhi sepse kur filloi intervenimi i policisë, dhuna që u ushtrua jo vetëm që jo vetëm nga policia po edhe nga civilët serb që ishin anash ishte e tillë që u bë presion, secili nga studentët të shkulej nga toka.

Në fakt veç ne që ishim në rendin e, rendet e para arritëm të ulëshim, ndërsa të tjerët jo sepse u bë intervenim në të gjitha anët. Edhe, edhe përkundër, edhe për kundër sigurisë shumë të madhe që ishin qytetarëve shqiptar që provuan t'i ruanin studentët mirëpo edhe gazi policor, hedhja e

plumbave të plastikës bëri efektin e vet, ideja ishte që të gjithë studentët të uleshim. Sepse neve, projekcioni jonë ishte që nuk do të ketë një intervenim jo të tillë, ndoshta ishin, ishin pritjet që dëshirat edhe pritjet ishin që nuk do të ketë intervenim të tillë. Mund të ketë shtyrje, mund të ketë, po jo intervenim ashtu përnjëherë ashtu që u ba, e kjo do të thotë që neve nuk arritë ta realizonim këtë që të uleshim të gjithë, të ishim në heshtje një minutëshe, dy-tre minutëshe pesë minutëshe.

Nuk arritën të gjithë studentët, që ishin pjesë e studentëve të uleshin. Këtë them që nuk u realizua, ndërsa ana tjetër ka qenë shumë e organizuar në çdo aspekt ishin grupet e, mobilet e ndihmës së shpejtë. Qytetartët ishin shumë vigjilent, shumë aktiv, ju përmbajtën planit që e kemi pasë, përgaditjet që t'i hapin dyert e shtëpisë se tyre, që t'iu ofronin ujë. Qe për shembull askush nuk flet për qepët. Është shumë interesant edhe s'ishte pjesë që u bë pjesë e kulturës, kur kish protestë qepët janë pjesë përbërëse e arsenalit të protestuesit.

Mirëpo, ujin ato qepët, t'i hapnin dyert njerëzit t'i futnin, për shembull një pjesë e studentëve ikën nga lagjja e Dodonës ku s'kishte, ku ishin të stacionuar, ku jetonin në fakt familjet prej komuniteti romë-ashkali-egjiptian. Edhe ata i hapën dyert, do të thotë nuk ishte më veç protesta e shqiptarëve ishte protesta e gjithë njerëzve që jetonin aty. Edhe pse po them, për me gjithë vullnetin e mirë edhe punën që është bërë, që kanë bërë ata familjarë edhe ata edhe ata banorë të Velanisë, nuk ju është vlerësuar ajo punë, nuk është çmuar asnjëherë. Sepse vërtetë njerëzit i kan hap dyert, pa pa interes tjetër. T'u e pasë parasysh që Velania ka pasë një, një pjesë e qytetarëve që kanë pasë një standard ndoshta pak më të lartë sesa pjesa tjetër e qytetit, kjo sa i përket...

**Aurela Kadriu:** Cilat kanë qenë parullat, thirrjet kryesore të '97-tës?

**Mihane Salihu-Bala:** Oh, ka pasë plot, ka pasë plotë, ndoshta është dasht t'i marr ashtu të shkurara. Të drejtat, shkolla në gjuhën time, në gjuhën shqipe, nuk më kujtohen tash fjalë për fjalë. Ka pasë plotë, ka qenë një ekip i plotë i studentëve të Fakultetit të ndërtimtarisë edhe të arkitekturës që i kanë shkruar ato parulla po, "Dua Paqe!" njëra për shembull. Nuk, nuk më kujtohen edhe pse i kam fotografitë në shtëpi, po ja tani nuk më kujtohen. Po kryesisht kanë pasë të bëjnë me me me mësimin, me shkollën, me paqen, çka, të drejtat e njeriut për shembull. Na, në protestën e 1 tetorit sepse në protestat e tjera ka pasë parulla NATO që nuk ka qenë pjesë e, e protestave të 1 tetorit.

**Aurela Kadriu:** '98, çka ndodh me juve në '98-tën thatë që jeni punësu...

**Mihane Salihu-Bala:** Po, do të thotë kam vazhduar aktivitetin pranë Unionit të Studentëve të Pavarur në, në, në nëntorë të '98-tës, e atëherë kam filluar të punojë për Karitasin Zviceran, një organizatë humanitare e kohës. Edhe para asaj kohe do të thotë në fillimin e '98-tës kam filluar në mënyrë vullnetare të shkojë me, të bëjë përkthim me gazetar që kanë punuar, që kanë raportuar nga terreni do të thotë gazetarët e huaj që kanë shku në zonat e luftës.

Unë shpesh herë iu jam bashkëkangjitur si përkthyes vullnetare e tani ka pasë raste edhe me pagesë po ekskluzivisht si përkthyes vullnetare në teren. Do të thotë, kam qenë një lloj, njëra nga anëtarët e kryesisë së Unionit të Pavarur të Studentëve që kam shkuar në teren me gazetarët do të thotë. Po jo

për për, për të bërë veç për nevojat të Unionit por për të parë situatën për të ndihmuar, për të dërguar, e gjatë asaj kohe dhe falë bashkëpunimit të ngushtë me Gratë në të Zeza. Kohë pas kohe kam dërgu insulinë në teren, Gratë në të Zeza kanë sjell nga përmes gazetarëve të ndryshëm insulin. Edhe unë kam dërguar nëpër teren aty ku kemi shku me gazetarë i kemi vënë, lanë njerëzve që kanë qenë kompetent për, për çështjen e çështje shëndetësore të mjekësisë në atë kohë.

Pothuajse kështu kam vazhduar më tepër edhe njejtën kohë kam qenë edhe pjesë aktive e Unionit të Pavarur të Studentëve. Do të thotë, të gjitha protestat që janë bërë nën patronatin e Unionit të Studentëve të Pavarur kam qenë pjesë e tyre. E pastaj kam filluar të punojë në teren me krejt Karitasin Zviceran, kemi shkuar nëpër të gjitha pjesët e Kosovës aty ku kanë qenë krizat e luftës, ku kanë qenë të zhvendosurit. Ka qenë një bashkëpunim i të gjithave organizatave ndërkombëtare të huaja që kanë qenë në atë kohë, ne kemi qenë pjesë përbërëse e, e secilit veprim në teren, kjo është.

Ndërsa fillimi i bombardimeve mua më ka gjetë në Prishtinë, do të thotë unë kam qenë në familje. Gjatë tërë kohës kam qenë në Kosovë. Kemi qenë të zhvendosur nga, nga mesi i marsit deri me 20 prill kemi qenë të zhvendosur në pjesën e Gollakut do të thotë në fshatrat e Marecit edhe Mramorit. Edhe unë jam kthyer në Prishtinë me 19 Prill jemi kthyer, 18-19 midis 18-19 natës, 18-19 Prillit jemi kthyer në Prishtinë edhe kemi qenë gjatë tërë kohës në Prishtinë.

Familja ime kanë provuar disa herë, vëllezërit, prindërit, vëllezërit edhe motrat të kalojnë në Maqedoni, mirëpo nuk janë lejuar sepse tanimë nuk na lejohej të kalojmë, të zhvendosim, të largoheshim nga shtëpia. E gjatë asaj kohe ka pasë disa kontrollera policore që kanë, më kanë kontrolluar me emër dhe mbiemër, por gjithëmonë kam thënë që jam motra tjetër sepse një rast njëra nga motrat nuk ishte në shtëpi edhe unë e shfrytëzoja emrin e saj për të qenë, për t'u prezantuar. Pas 20 Prillit neve u detyruam ata që ishim, mbetëm në Prishtinë të bënim një llojë kartoni të gjelbërt që u ba, pa atë karton nuk mund të lëvizje dhe njëfarë llojë evidentimi i njerëzve që ishin mbrenda për mbrenda vendit.

Ky është momenti që ndoshta ngjason shumë me, me, me trajtimin e Hollokaustit sepse ti kishe një dokument që të bënte të veçantë, të ndryshëm nga tjerët. Edhe ishte ai kartoni i gjelbërt nuk ishte i verdhë po ishte i gjelbërt, do të thotë i shkruar si ishte i shkruar dhe tregonte emrin, mbiemrin, kush je, ku jeton edhe për të dal nga lagjja ime, për të shkuar... Për të siguruar dikund ushqim sepse u paksuan të gjitha rezervat.

A din, se vetëm dyqanat në Prishtinë kishin ushqime që shiteshin me çmime astronomik. Në patrullën e parë të ushtrisë duhesh tregojë atë, pa atë nuk mund të kaloje. Mirëpo, edhe përkundër luftës, njerëzit kanë dal edhe unë kam dal, jo për çdo ditë normal, po kam dal nga ora 11:00, 12:00, për të parë, për të takuar, për të provuar të gjetë njerëzit e familjës.

Kështu që me, në, do të thotë intervenimin e NATO-s, futjen e forcave t'para pjestarëve, të departamenteve jo, po të KFOR-it unë kam qenë në Prishtinë. Edhe qershori, 11 qershori, 11 edhe 13 qershori kanë qenë datat pothuaj se më të rënda të krejt asaj peripetie. Sepse nuk dihej kush po hynte dhe kush po dilte, dhe çfarë po bëhej. Në njërin anë shiheshin forcat ushtarake të Serbisë edhe



policore duke u larguar. Në anën tjetër flitej që hynin forcat e NATO-s. E njerëzit e parë të armatosur nga forcat e NATO-s janë njësia e Burkave. Që, që (buzëqeshë) më ka mbetë në mendje ashtu. Edhe njësitë ruse, që kanë hyrë në Prishtinë në atë kohë dhe kanë filluar t'a kontrollonin konvojën, t'a ruanin konvojën e sërbeve që largoheshin nga Prishtina. Kjo është me pak fjalë deri në qershorin e '99-tës.

**Aurela Kadriu:** E përmendët që keni qenë në terren si përkthyes. A na tregon për përvojën?

**Mihane Salihu-Bala:** Përvoja në terren ka qenë... (psherëtinë). Sot nuk do t'a bëja të njejtën gjë. Sot nuk do t'a bëja të njejtën gjë. Me gjithë dëshirën, vullnetin, përgaditjen teorike që e kemi pasë, përvoja në terren ka qenë shumë e randë. Unë kryesisht kam ndihmuar me përkthim gazetarëve të huaj. E të njejtën kohë kam parë edhe gjendjen në terren. Gjendja ka qenë shumë e randë, sidomos për ata që kanë qenë të zhvendosur, që kanë jetuar në rajone të caktuara. Për shembull Kishnarekë, për shembull në Kishnarekë ku kanë jetuar nëpër atë... janë grumbulluar njerëzit kanë jetuar nëpër ata shatorat e plastikës, mjerimi.

Një rast tjetër që m'kujtohet është në Pagarushë. Ku një grua e re ka lindë fëmijun në mal. Edhe për shkak të gjendjes të randë të nënës, në atë kohë misioni i KDOM-it, që më vonë është bërë misioni OSBE-së... Pas një, një debati shumë të madh, lidhjeve, bisedave përmes këtyre radio-lidhjeve të vendosin a ta marrin atë gruan të re me fëmijun në spital a jo (buzëqeshë). Kjo është një moment shumë i randë që unë e mbaj n'mend edhe besoj që çfarëdo që të ndodhë... Edhe në vendet tjera kur kam qenë ku kanë qenë krizat e para luftës ose konflikteve, asnjëherë nuk jam ndier si aty. Do të thotë, një grua e re që fatkeqësisht pat fatin të lindte në mal dhe gjendja e saj e rëndë, dhe pamundësia për t'i ofru ndihmë mjekësore.

Do të thotë mua më kujtohen disa prej kolegëve që ofruan që ata të rrijnë në mal edhe dhe misioni t'a merre gruan me fëmijun. Mirëpo ishte e pamundur edhe në fund kjo ka mbetë punë.... Unë nuk e di ku ka përfunduar ajo grua, edhe sot e kësaj dite nuk kam pasë guximin as të pyes, as të mendoj shumë. Sepse në fund UNHCR-i e ka marrë përsipër t'a zgjidh situatën.

E ajo që mbaj në mend është, gjatë kësaj punës me gazetarë edhe organizatat ndërkombëtare është që friga, dëshpërimi i njerëzve dhe pamundësia e tyre për të bërë asgjë për vetën e tyre. Shkoje, i shihje, dërgojë të mira materiale sa kishe mundësi, sidomos kur u organizonim.... Po një moment tjetër që ndoshta duhet të përmendet edhe është shumë me rëndësi për kujtesën tonë kolektive është puna dhe kontribti i vullnetarëve dhe aktivistëve të shoqatës "Nëna Terezë". Sepse të gjitha orgaizatit kombëtare pikë referimi i kanë pasë qendrat e shoqatës së "Nënë Terezës", degët e tyre, qendrat e tyre nëpër fshatëra. Kjo është.

Edhe moment tjetër shumë i randë gjatë punës time në terren është vrasja e doktor Robajt. Vendi ku unë kam shku në terren pastaj edhe pamja që shihet në atë vend është, është e tmerrshme. Pastaj rasti tjetër është vizita në Reçak, dy apo tre ditë pas masakrës së Reçakut. Edhe gjurmët e kufomave nëpër vendet ku kanë qenë. Do të thotë tek, aty ku i kanë ekzekutu, edhe tek vendi i fundit ku familjarët i kanë marrë tek xhamia e fshatit.

Ajo... edhe moment tjetër është pas Prekazit. Pas luftës në Prekaz, pas vrasjës së familjës Jashari, Jasharajve. Unë kam shkuar më vonë do të thotë, ka qenë tre-katër ditë me vonë, nuk jam shumë e sigurtë tani. Edhe era e barutit që ndihej ende rreth shtëpisë, rreth oborrit në atë vend. Ajo është, ajo, atë përvojë, atë moment, atë kujtim është vështirë t'a largosh nga mendja dhe një kohë shumë të gjatë më vonë. Kjo është (buzëqeshë).

**Aurela Kadriu:** Mandej mbas luftës çka keni vazhdu?

**Mihane Salihu-Bala:** Mbas luftës kam filluar të marrë frymë prapë (buzëqeshë).

**Aurela Kadriu:** Do të thotë çka ka ndodhë në jetën e juv personale?

**Mihane Salihu-Bala:** Pas luftës, pas luftës... E tash luftë, para luftës, gjatë luftës, kjo është një problem sepse...ka përfunduar lufta fizike, beteja... lufta nuk ka përfundur as në të '99-tën, as tash nuk përfundon. Është ajo vazhdimësia që ty do të ndjekë sepse përvojën, emocionin, dhembjën, vragët, plagët që i ke nga ajo koha do të përcjellin një kohë të gjatë. Mirëpo unë edhe atëhere kam thanë, edhe tash e ndaj mendimin që lufta ishte, përfundoi si e tillë, fizike dhe unë duhet të vazhdoj t'bëhem gati nesër t'shkoj në punë. Sepse e vetmja mënyrë për t'a mbijetuar veten ishte t'filloje...

Unë vazhdova prapë të punoj me misionin Zvicëran në atë kohë. Edhe ditët e para të punës do të thotë në qershor jo, por në korrik të '99-tës daljet në terren, inçizimi i situatës në terren, mbledhja e të dhënave, takimi me njerëz, takimi me nevoja të tyre të për çdo ditshme, takimi me hallet e tyre të ekzistencës, strehimit. Angazhimi shumë i madh i njerëzve, organizatave që u bë për t'u ngritë ky popull, ky vend... Kanë bërë, kanë qenë zhvillime shumë të shpejta. Do të thotë, ajo çfarë mua më ka bërë përshtypje është që njerëzit nuk kanë pritë të gjithë ndihmën nga të tjerët. Edhe me forcat e veta kanë bo, kanë ndërtuar shtëpitë për shembull. Është e, e mahnitshme ndihma e diasporës.

Ne e kemi si concept ashtu se duhet. Jo, njerëzit kanë lënë gjithçka, kanë bërë investimin, e kanë dhuru investimin e tërë jetës, kanë ndërta shtëpitë e tyre. Do të thotë, nuk kanë pritë që t'ua ndërton dikush shtëpitë, njerëzit kanë bërë zgjidhje. Po në anën tjetër ka pasë shkatërrime shumë të mëdha. Nuk është veç shkatërrimi fizik edhe material, i të mirave materiale, i shtëpive të djegura e krejt. Po shkatërrimi i qenjes njerëzore. Do te thotë, me gjithë vullnetin që të punohet e të bëhet, ne nuk kemi mrrri me punu në të gjitha aspektet njejtë, paralel.

Për shembull kemi punuar shumë për rindërtimin, për strehimin, për ushqimin... Mirëpo, për me u punu me rehabilitimin e traumave, nuk kemi mrrri shumë të punohet në fillim. Në anën tjetër, një moment tjetër kyç i, i rëndesës shoqërore është të zhdukurit. Askush nuk ka pranuar të flas, ose t'a pranoj faktin se këta të zhdukur janë të vrarë. Gjithmonë është ajo shpresa që ata janë dikun dhe do të kthehen. Kjo është një pasojë tjetër e luftës edhe e pamundësisë të shoqërisë tonë që të punojmë në këtë aspekt. Është punuar, është provuar, mirëpo nuk është punuar sa duhet.

Pastaj trajtimi i kategorive të ndryshme, të dalura pas luftës, qoftë grave që kanë mbetë pa burrat e tyre, nënave vetë-ushqyese, nëna të vetme që u bënë, të vejave të luftës, të dhunuarve të luftës, se ka

pasë edhe të dhunuara, edhe të dhunuar, të torturuarve gjatë luftës, pasojave që vijnë... të fëmijëve që kanë mbetë pa prindër. Është provuar të punohet shumë, mirëpo nevojat kanë qenë shumë të mëdha, por mundësitë tona kanë qenë shumë të vogla.

Kështu që, të punohet me një grua që ka qenë e dhunuar në atë kohë, edhe të ndërtohet shtëpia që të ketë një strehim, të ketë ushqim. Është provuar të punohet edhe në aspektin tjetër, mirëpo nevojat kanë qenë shumë të mëdha, ndërsa mundësitë kanë qenë shumë të vogla. E mira e krejt kësaj fatkeqësie është që shkollat kanë filluar menjëherë (buzëqeshë). Edhe ajo ka qenë momenti më rilindës i krejt kësaj shoqërie.

Do të thotë përfundoi lufta, tani vazhdojmë me jetën. Gadishmëria e njerëzve për ta tejkaluar dhembjen emocionale, fizike, për t'iu kthyer jetës ka ba që shumë shpejtë njerëzit njëfarë mënyre të mendohet që... Sepse pritshmëritë kanë qenë të mëdha, edhe është menduar që të kalohen e të bëhet mirë. Edhe kjo entuziazëm ka zgjatë për dy-tri vite, deri sa njerëzit kanë filluar prapë të kthehen në stadin e dëshprimit social-shoqëror. Edhe, edhe në pjesë e saj.

Kështu që, kjo periudha e pas luftës është ajo pritja, shërimi, rehabilitimi shpirtëror. Dëshira për të ndryshuar, për t'u ngritur. Dëshprimi në shoqëri, dëshira për të qenë vend i pavarur. Në anën tjetër pamundësia për t'u ofruar shumë gjëra për këtë vend. Këto janë ato sfidat me të cilat po vazhdojmë tash e 18 vjet, hë?

**Aurela Kadriu:** Çka ka ndodhë ndërkohë me juve? Deri në cilin vit keni punu?

**Mihane Salihu-Bala:** Ndërkohë unë kam filluar, unë kam filluar, vazhduar edhe të punoj për organizata të ndryshme. Edhe në vitin 2000 kam qenë, 2000, po në vitin 2001 kam qenë në një vizitë studimore në Afrikën e Jugut, që ka pasë t'bjë për konfliktet ndër-etnike dhe ndër-fetare. Pastaj kam vazhduar në Akademinë Humanistike në Lilihamer, në Norvegji tek dialogu, tek dialogu, temën për dialog, edhe menaxhimin e konflikteve. Kam punuar një kohë të gjatë me për konfliktet ndër-etnike dhe ndër-fetare në programe të ndryshme. Edhe kështu (buzëqeshë), këtu jam ende. Kjo është fusha me të cilën unë parapëlqej të punoj.

Ka pasë disa momente në jetën time... Jam bërë nënë, në 2007-tën. Kam një gocë të lindur në 2007-tën. Gjatë asaj kohë, deri atëherë kam punuar, tani një kohë kam mbetë pa punë, pasi kam lindë gocën kam mbetë pa punë. Kam punuar veç një vjet në 2011 në program për parandalimin e konflikteve. Pastaj prapë kam mbetë pa punë. Kam një çun, një çun në 2012-tën. Edhe nga ajo kohë jam ende e papunë. Kështu që, kjo është ajo çfarë ka ndodhë me mua.

Në ndërkohë, tash kam regjistruar studimet master (buzëqeshë). Ashtu pak ndoshta me vonesë në këtë far faze të jetës. Edhe pse nuk janë studimet e para master, mirëpo janë këto të para këtu tani, në degën e Sociologjisë. Në Departamentin e Sociologjisë, në kuadër të Fakultetit filozofik.

**Aurela Kadriu:** Cilat kanë qenë tjera, m'fal?

**Mihane Salihu-Bala:** (Qeshë) Nga akademia në Lilihamer kam vazhduar provime të ndryshme, trajnime të ndryshme për konfliktet ndër-etnike dhe ndër-fetare. Edhe trajnime të ndryshme për ndërmjetësim në konflikte kështu që një lloj pune me një aftësim profesional të vazhdueshëm. Por që te ne nuk ka konflikte ndër-etnike dhe ndër-fetare kështu që jam tani tek shtëpia, tani e bëjë shtëpiaken edhe studentën, kur të mrrij (buzëqeshë). Kjo është me pak fjalë.

**Aurela Kadriu:** Do me thonë nuk keni diçka me shtu? N’fakt e kom veç edhe një pyetje shumë shkurtë që mendoj që është shpjeguese për kontekstin. E keni përmendur në fillim komplet lojën “Partizanët edhe gjermanët”, qysh ka qenë kjo lojë?

**Mihane Salihu-Bala:** Kjo lojë ka qenë reflektim i filmit *Boško Buha* (buzëqeshë).

**Aurela Kadriu:** Qysh është lujtë loja se...

**Mihane Salihu-Bala:** Po një grup i fëmijëve janë bërë gjerman, edhe grupi tjetër janë bërë partizan. Gjithmonë kanë fituar partizanët (buzëqeshë). Kështu ishte, në fakt ishte lojë e fëmijëve të kohës, banin ca stiva ashtu pas një muri njëri grup, grupi tjetër pas një muri, ose pas një barriere të improvizuar. Dhe kishim ato lodrat në formë armësh, ishin o të drurit, o të plastikës ose... Do të thotë ishte, ajo ishte loja. Dhe bëheshin një grup partizan, dhe një grup gjerman. Ndrroheshim, po secilën herë fitonin gjermanët. Sepse ishte nën ndikim e sistemit. Kjo lojë nuk është lujtur veç tek ne, është lujtur në tërë ish-Jugosllavinë. Kështu që, është luajtur edhe në Shqipëri kam dëgjuar, po jo si partizanët dhe gjermanët, po si partizanët edhe të tjerët.

Ka qenë lojë e shteteve socialiste që është luajtur. Do të thotë njo lloj argëtimi, po nën ndikimin e sistemit. Sepse ne ishim pionerë në atë kohë, edhe gjithkush që shkone në klasën e parë bëhej pioner. Edhe ishte, ishte ndikimi i kohës do të thotë po flasim për vitet e ‘70-ta, lufta ka përfundu në ‘45, edhe ne ende luanim “Partizanët edhe gjermanët”. Do të thotë ëshë ushqyer ajo fryma e të qenurit partizan (qeshë). Normal ishte mirë të ishe partizan se fitoje, por edhe kur të binte rendi të ishe gjerman, s’ka loja i ka rregullat e veta. Partizanët gjithmonë fitonin. Edhe kjo.

**Aurela Kadriu:** Okej, nëse nuk keni diçka me shtu, faleminderit shumë për intervistën.

**Mihane Salihu-Bala:** Aq ishte. S’kam për të shtuar diçka tjetër përveç ndoshta, përvoja jetësore nuk ka çmim. Edhe një gjë tjetër është, po të kisha mundësi të kthehesha prapë nga fillimi, prapë të njejta gjëra do i bëja. Ndoshta jo me njerëzit e njejtë, ndoshta të kisha mundësi të i ndrroja njerëzit, do i ndrroja, mirëpo mendoj që prapë do i bëja gjërat e njejtë.

**Aurela Kadriu:** Faleminderit shumë.

**Mihane Salihu-Bala:** Asgjë (buzëqeshë).